



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 17 regjistër (JR)
Datë 13.04.2021

Nr. 1 i vendimit
Datë 17.01.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 17.01.2024, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 17/2021 (JR), datë 13.04.2021, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 307, datë 12.10.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, Ç, D e në vijim të Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e

mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6 e në vijim.

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet e dorëzuara në Kolegji, e cila kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 307, datë 12.10.2020 dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, ka ushtruar detyrën si gjyqtare që prej vitit 1993 dhe, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ajo iu nënshtua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë², deklaratën për kontrollin e figurës³ dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁴.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*

¹Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

²Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 30.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 30.01.2017. Të njëjtën datë mban dhe deklarata e pasurisë në rubrikën përkatëse.

³ Referuar raportit të grupit të punës me nr. {***}, datë 30.10.2017, me lëndë “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Etleva H. Temo (Z.)”, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZh-së nr. {***}, datë 30.06.2020. Formulari i vetëdeklarimit rezultoi të jetë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016.

⁴ Referuar raportit nr. {***} prot., datë 27.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Etleva Temo” për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”, subjekti i rivlerësimit rezultoi ta ketë dorëzuar formularin e vetëdeklarimit pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, më datë 30.01.2017.

(iii) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.

(iv) Nuk ka kryer deklarim të rremë.

(v) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.
5. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Etleva Temo, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 307, datë 12.10.2020, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Apelit Korçë [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.
 - Në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë: *Bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo: a. ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; b. ka kryer deklarim të rremë të pasurisë dhe veprime fiktive; c. ka zhvilluar procese gjyqësore në situatë konflikti interesi; d. nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi saj, personave të lidhur me të, nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara, në shumën -3.216.314 lekë. Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.*

- Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, kreut V të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, është e përshtatshme për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.
- Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, kreut VI të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

9. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 307, datë 12.10.2020, me pretendimin se vendimi është rezultat i një procedure joligjore të ndjekur nga Komisioni, në shkellje të Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, është cenuar e drejta e subjektit për proces të rregullt ligjor sipas nenit 6 të KEDNj-së, si pasojë e mosrespektimit gjatë procesit të hetimit dhe vendimmarrjes së Komisionit të: (i) parimit të ligjshmërisë; (ii) parimit të drejtësisë dhe paanësisë; (iii) parimit të barazisë para ligjit; (iv) parimit të mbrojtjes juridike e lirive dhe të drejtave Kushtetuese; si dhe (v) parimit të proporcionalitetit. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, vendimi objekt ankimi është rezultat i një procesi të paragjykuar dhe rrjedhojë e mosbërjes së një analize të provave të dorëzuara prej saj.
10. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, nuk ka dorëzuar bashkëlidhur ankimit të saj ndonjë akt për të cilin të ketë kërkuar administrimin e tij në cilësinë e provës së re në proces, por kërkoi gjykimin e çështjes në seancë publike me praninë e saj, duke riçelur/përsëritur hetimin gjyqësor me qëllim marrjen në shqyrtim dhe analizimin e provave të depozituara në dosjen e Komisionit, në funksion të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike. Bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe neneve 51 dhe 53/b të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
 - Gjykimin e çështjes në seancë publike.
 - Ndryshimin e vendimit nr. 307, datë 12.10.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
 - Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
11. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të zhvilluar në Komision, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
 - 11.1. Vendimi i marrë nga Komisioni është rezultat i shkelljes së Aneksit të Kushtetutës dhe një procesi të paragjykuar, si pasojë e mosbërjes së një analize të hollësishme të provave që iu nënshtruan shqyrtimit gjyqësor të çështjes.
 - 11.2. Procesi i rivlerësimit në Komision është zhvilluar në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor, referuar nenit 6 të KEDNj-së, pasi nuk janë respektuar kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca e GjEDNj-së (duke referuar në çështjen Voklov kundër Ukrainës), në drejtim të

garantimit të pavarësisë dhe paanësisë së organit që ka dhënë masën disiplinore, lidhur me: (i) përfaqësimin thelbësor të gjyqtarëve në organin disiplinor; (ii) mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve dhe ekzistencën e garancive ndaj presioneve të jashtme; (iii) faktin e dublimit të funksioneve, gjë që mund të hedhë dyshime objektive mbi paanshmërinë e anëtarëve të organit disiplinor; si dhe (iv) kohëzgjatjen e mandatit të tyre.

11.3. Komisioni ka cenuar parimin e barazisë së subjekteve para ligjit dhe mosdiskriminimit pasi në raste të ngjashme objektive, për të tjera subjekte rivlerësimi, ka vendosur konfirmimin në detyrë dhe jo shkarkimin si në rastin objekt gjykimi.

11.4. Komisioni ka cenuar procesin e rregullt ligjor pasi nuk i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për deklaram të rremë të pasurisë.

12. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

*i. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament me sip. 79,7 m²”, në rrugën “{***}”, Pogradec:*

12.1. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se mosdeklarimi i kontratës së shitblerjes së apartamentit në vitin 2009 është pasojë e një gabimi njerëzor (harrese) dhe se kjo kontratë ka qenë thjesht një formalizim i detyrimeve të deklaruara në këtë DIPPV, duke iu referuar detyrimeve të deklaruara mbi kredinë e marrë për efekt të blerjes së apartamentit.

*ii. Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit “automjet” të tipi “Fiat Lancia”, me vit prodhimi 1999, me targë {***}, blerë në vitin 2015 dhe shitur në vitin 2016:*

12.2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, kundërshtoi si të gabuar rezultatin e analizës financiare të kryer nga Komisioni lidhur me krijimin e kësaj pasurie në vitin 2015, si pasojë e mosmarrjes në konsideratë të kursimeve, si dhe mosllogaritjes së huasë së marrë nga S. K., në vlerën 8.000 euro, si dhe balancës negative të konstatuar për vitin 2016, e cila, sipas saj, vjen si rrjedhojë e keqlllogaritjeve të shpenzimeve për hyrje-daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë.

12.3. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mospërmbushjen e detyrimeve tatimore për shumën prej 200 eurosh, të përfituar nga shitja e automjetit me pretendimin se kjo shumë nuk bën pjesë në të ardhurat e tatueshme referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, të ndryshuar, pasi, sipas saj, kjo shumë nuk përbën fitim.

*iii. Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit “automjet” të tipit “Ford Mondeo”, vit prodhimi 2006, me targë {***}, të blerë në vitin 2013, në vlerën e 4.000 eurove:*

12.4. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë dhe të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mosvlerësimin si të ardhur të ligjshme të vlerës prej 1650 eurosh, të përfituar nga shitja e automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, dhe të përdorur si burim për blerjen e automjetit të tipit “Ford Mondeo”, me pretendimin se kjo vlerë (1650 euro), e përfituar nga çmimi i shitjes, nuk

bën pjesë në të ardhurat e tatueshme, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke qenë se nuk përbënte fitim për sa kohë është shpenzuar për mirëmbajtjen e mjetit në 6 vite dhe çmimi i shitjes reflektonte këto shpenzime.

*iv. Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit “automjet” të tipit “Mercedes Benz”, me targë {***}, blerë me kontratën e datës 16.05.2007, në vlerën e 1850 eurove (i shitur):*

12.5. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për veprime të pajustificueshme të blerjes dhe shitjes së këtij automjeti nga bashkëshorti, z. A. T..

*v. Lidhur me automjete të mëparshme të tjetërsuara (shitur, shkëmbyer), konkretisht lidhur me automjetin “Mercedes Benz” të tipit “190 D”, me targë {***}, të blerë në vitin 2002, në vlerën e 200.000 lekëve dhe automjetin “Mercedes Benz”, me targë {***}, i këmbyer me automjetin “Mercedes Benz” të tipit “190 D”, me targë {***}, sipas kontratës së shkëmbimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.09.2005, të lidhur para noterit Th. B., dhoma e noterisë Pogradec:*

➤ *Për automjetin “Mercedes Benz”, tip “190 D”, me targë {***}*

12.6. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e arritur nga Komisioni për veprime fiktive në lidhje me këtë automjet, me pasojë pasaktësi në deklaram.

12.7. Subjekti pretendoi se për ekzistencën e dy kontratave të lidhura në të njëjtën datë për këtë automjet, konkretisht një kontratë shitjeje dhe një kontratë shkëmbimi, kanë marrë dijeni vetëm pas marrjes së rezultateve të hetimit dhe për këtë çështje kanë ndjekur rrugën ligjore, duke paraqitur kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me pretendimin se kontrata nuk është nënshkruar nga z. A. T..

➤ *Për automjetin “Mercedes Benz”, me targë {***}*

12.8. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar dhe të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë automjet, me pretendimin se Komisioni nuk ka bërë një vlerësim të drejtë të përgjigjeve, fakteve dhe provave të administruara, si dhe ka mbajtur qëndrim me dy standarde.

12.9. Në lidhje me shitjen e automjetit me targë {***}, subjekti kundërshtoi si të pasaktë konkluzionin e Komisionit për veprime fiktive në lidhje me dy kontratat e shitblerjeve të këtij automjeti, si dhe të pabazuar konkluzionin e Komisionit në lidhje me pagesën e kështit prej 4.000 eurosh nga z. S. Z., në kuadër të kontratës së shitblerjes së automjetit me targë {***}.

12.10. Subjekti kundërshtoi konkluzionin e Komisionit mbi mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin nëpërmjet shkëmbimit të automjetit me targë {***}, sipas pretendimeve të ngritura në lidhje me mjetin “Mercedes Benz”, me targë {***}.

12.11. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se ka përfituar nga z. G. A. një automjet pa shkëmbim dhe pretendoi se nuk ka pasur asnjë arsye të përfitohej një mjet pa shkëmbim nga ky shtetas, për sa kohë as ajo, as bashkëshorti i saj, referuar verifikimeve të kryera

nga Komisioni, nuk kanë pasur ndonjë lidhje direkte apo indirekte apo të ketë qenë në kushtet e konfliktit të interesit me z. G. A. në momentin e shkëmbimit të automjeteve.

12.12. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi gjithashtu si të pabazuar në fakte dhe në ligj konkluzionin e Komisionit se gjykimi nga subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, i çështjes gjyqësore në vitin 2018, me palë ndërgjyqëse z. G. A., i cili ka rezultuar fitues, është kryer në situatë konflikti i interesit të subjektit me këtë shtetas.

*vi. Lidhur me kontratën e huasë së lidhur mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe z. S. K., në shumën 8000 euro, sipas kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.01.2015, e depozituar pranë Societe Generale Albania:*

12.13. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me mosjustifikimin e ligjshmërisë së shumës së marrë hua dhe pretendoi se ka paraqitur prova të mjaftueshme sipas të cilave vërtetohet mundësia e huadhënësve për të justifikuar me burime të ligjshme krijimin e shumës së dhënë hua, prej 8.000 eurosh.

vii. Lidhur me shumën e mbetur pa shlyer që përfaqëson qiranë, sigurimin shëndetësor dhe shkollimin deri në përfundim të vitit shkollor, tetor të vitit 2017, të djalit të subjektit të rivlerësimit A. T., në shumën 3.014,8 euro:

12.14. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këto shpenzime, duke pretenduar se deklaratimet e saj lidhur me shpenzimet e shkollimit të djalit të saj A. T. në Gjermani, kanë qenë të sakta dhe provohen nga lëvizjet bankare.

viii. Lidhur me depozitat bankare në emër të subjektit të rivlerësimit pranë Procredit Bank, në shumën 50.000 lekë, krijuar më datë 22.01.2004, dhe 2.000 USD, krijuar më datë 05.02.2004:

12.15. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit sipas të cilit subjekti nuk ka provuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre depozitave dhe pretendoi se burimi i tyre kanë qenë kursimet nga pagat nga viti 1994.

*ix. Lidhur me zotërimin nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të (bashkëshortit) të aksioneve në shoqërinë “{***}” ShA, secili nga 50 aksione gjithsej, me vlerë 50.000 lekë ose 0,00027% e kapitalit:*

12.16. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit lidhur me mosdeklarimin e zotërimit të aksioneve pranë shoqërisë “{***}” ShA dhe pretendoi se mosdeklarimi ka ardhur si rezultat i mosqenies në dijeni të regjistrimit të këtyre aksioneve në regjistrin tregtar. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vlera e këtyre aksioneve është e papërfillshme dhe se as ajo dhe as bashkëshorti i saj nuk kanë përfituar ndonjëherë të ardhura të shpërndara nga kjo shoqëri në formën e dividendit.

x. Subjekti kundërshtoi si të padrejtë dhe të pabazuar konkluzionin e Komisionit se ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, referuar ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e

konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, kur ka gjykuar çështjet gjyqësore të shoqërisë “{***}” ShPK dhe administratorit V. G., me pretendimin se bashkëshorti ka qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie për një periudhë të shkurtër, nga 12.11.2016 - 31.12.2016, ku ka përfituar pagën prej 68.440 lekësh. Sipas subjektit, në kohën kur janë dhënë vendimet e evidentuara nga Komisioni, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë në marrëdhënie pune pranë kësaj shoqërie.

xi. Lidhur me rezultatin e analizës financiare:

12.17. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pasaktë rezultatin e analizës financiare të Komisionit për periudhën e viteve 2003-2016, me pamjaftueshmëri burimesh në vlerën e 3.216.314 lekëve, duke evidentuar se: (i) vlera e aksioneve në “{***}” ShA nuk është pasqyruar me koston reale të shpenzuar për blerjen e letrave me vlerë; (ii) shpenzimet e jetesës nuk janë reduktuar për dy fëmijët e subjektit për periudhën kur ata kanë frekuentuar shkollën “{***}”, duke qenë se në pagesën pranë kësaj shkolle është përfshirë edhe ushqimi (mëngjes, drekë dhe zëmër) dhe veshja; (iii) nuk janë reduktuar shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit; (iv) nuk janë përfshirë të ardhurat nga shitblerja e automjeteve; si dhe se (iv) nuk është përlogaritur gjendja e likuiditeteve *cash* ndër vite.

xii. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar në ligj edhe konkluzionin e Komisionit lidhur me trajtimin e denoncimit të shtetasit A. M., me pretendimin se nuk ka qenë asnjëherë në kushtet e nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

- 13.** Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, znj. Etleva Temo, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

- 14.** Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë

Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁵ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

15. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”, i ndryshuar), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 307, datë 12.10.2020, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
16. Pas regjistrimit në Kolegji të çështjes së juridiksionit të rivlerësimit nr. 17/2021 (JR), datë 13.04.2021, që i përket ankimit të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, kjo e fundit, në mbështetje të pretendimeve të ngritura në ankim për riçelje të hetimit gjyqësor, depozitoi në Kolegji, më datë 11.05.2023, një kërkesë për marrjen në cilësinë e provave të reja në proces dhe shqyrtimin nga Kolegji të:
 - a) vendimit nr. {***}, datë 31.05.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec;
 - b) aktit të ekspertimit grafik, shkrimi dhe nënshkrimi, nr. {***}, datë 12.04.2021.Ky vendim i cili kishte marrë formë të prerë në datën 16.06.2021, lidhej me kallëzimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. A. T., për të cilin Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec kishte regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë regj. 28.10.2020, për veprat penale “Falsifikim dokumentesh” dhe “Shpërdorim detyre”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal. Referuar vendimit të sipërcituar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec kishte vendosur miratimin e kërkesës së Prokurorisë Pogradec për pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë regj. 28.10.2020, për veprën penale “Falsifikim dokumentesh” dhe “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, për shkak se këto vepra penale ishin parashkruar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në zbatim të nenit 190/b të K.Pr.Penale, vendosi asgjësimin e provës materiale “kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 13.09.2005, me shitës A. T. dhe blerës F. Ç., hartuar nga noteri L. I.”, pasi më parë kishte vlerësuar se kjo kontratë ishte e falsifikuar, duke qenë se nuk ishte nënshkruar nga kallëzuesi, z. A. T..
17. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit për çelje të hetimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

⁵ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 307, datë 12.10.2020, për rivlerësimin e subjektit, znj. Etleva Temo, i është njoftuar kësaj të fundit me shkresën nr. {***} prot., datë 23.03.2021, konfirmuar marrja dijeni nga subjekti i rivlerësimit më datë 25.03.2021, sipas lajmërimarrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezultoi të jetë depozituar në Komision në datën 06.04.2021, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit nr. {***}, datë 06.04.2021, që rezultoi të jetë dita e 12 nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit.

18. Sa u takon akteve shkresore të sipërcituara, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e saj, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Në kuadër të analizës së mësipërme, trupi gjykues çmoi se aktet e dorëzuara në Kolegj përmbushin kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, por ato u vlerësuan të panevojshme sipas parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “a” të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se trupi gjykues mund të arrinte në vendimmarrje lidhur me këtë çështje nga gjykimi mbi bazë të dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit.
19. Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni

20. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi i marrë nga Komisioni është rezultat i shkeljes së Aneksit të Kushtetutës dhe i një procesi të paragjykuar, si pasojë e mosbërjes së një analize të hollësishme të provave që iu nënshtuan shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Në mbështetje të këtij shkak, subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, pretendoi se relatori në seancën dëgjimore në Komision, bëri të njëjtat konstatime me ato të dërguara në raportin e rezultateve të hetimit, ndërkohë që në lidhje me provat e dorëzuara prej saj rishtas nuk u mor asnjë vendim për administrimin e tyre, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën e subjektit për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të mosgarantimit të së drejtës për t’u mbrojtur dhe dëgjuar në mënyrë efektive, në përputhje dhe respektim të parimeve të ligjshmërisë, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, pretendoi në këtë drejtim se asaj nuk i është vënë në dispozicion analiza e detajuar financiare lidhur me vlerësimin e kryer nga Komisioni, as në kuadër të përcjelljes së rezultateve të hetimit dhe as pas marrjes së vendimit.
21. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, si dhe konstatoi se: (i) në përmbajtje të dokumentit “Relacion mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Etleva Temo”, i cili i është njoftuar subjektit

të rivlerësimit në kuadër të vendimit të Komisionit të datës 22.09.2020, për përfundimin e hetimit paraprak dhe kalimin e barrës së provës lidhur me rezultatet e tij, në faqet 58 – 61 të këtij materiali është përshkruar metodologjia e kryerjes së analizës financiare dhe në faqen pasardhëse është paraqitur kjo analizë që i përket periudhës së vlerësimit 2003-2016, ku vihet re të jetë marrë në analizë çdo vit në mënyrë individuale; dhe (ii) me vendimin e Komisionit të datës 07.10.2020, ky i fundit ka vendosur, ndër të tjera: *1. Të pranojë dhe të administrojë, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit – arriti në konkluzionin se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, qoftë për mosadministrimin nga Komisioni të provave të paraqitura prej saj gjatë procesit të hetimit në Komision, qoftë për mosbërjen me dije të analizës financiare në kuadër të përcjelljes së rezultateve të hetimit administrativ, nuk janë të bazuara në fakte. Subjekti i rivlerësimit nuk solli asnjë provë për të provuar faktin e pretenduar mbi mospërfshirjen e analizës financiare në dokumentin me të cilin i janë përcjellë rezultatet e hetimit administrativ.*

22. Sa i takon pretendimit tjetër të ngritur nga subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, lidhur me mënyrën e zhvillimit të seancës dëgjimore në të cilën, sipas saj, relatori i çështjes bëri të njëjtat konstatime me ato të dërguara në raportin e rezultateve të hetimit, pavarësisht provave dhe shpjegimeve të dorëzuara prej saj në përgjigje të rezultatit të hetimeve, trupi gjykues çmoi se kjo praktikë e ndjekur nga Komisioni nuk bie në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm në fuqi lidhur me procedurën e kryerjes së një hetimi administrativ, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, për sa kohë vlerësimi i Komisionit lidhur me shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit në formë të shkruar dhe verbalisht gjatë seancës dëgjimore, gjen trajtim në vendimin e arsyetuar, në një rubrikë të veçantë që u takon shpjegimeve të dhëna dhe provave të depozituara nga subjekti, në drejtim të çështjeve të marra në analizë nga Komisioni. Duke vlerësuar se qëllimi i seancës dëgjimore është të dëgjohet subjekti i rivlerësimit lidhur me barrën e provës që i ka kaluar nga Komisioni, përfshirë këtu dhe diskutimin e çdo akti të dorëzuar në cilësinë e provës që provon fakte që hedhin poshtë gjetjet e Komisionit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, nuk konstatoi që kjo e drejtë t'i jetë mohuar apo kufizuar subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të mosgarantimit të së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar në mënyrë efektive, në përputhje dhe respektim të parimeve të ligjshmërisë, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, nuk gjendet i bazuar në fakte.

23. *Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, pretendoi se procedura e rivlerësimit të saj në Komision, është zhvilluar në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor referuar nenit 6 të KEDNj-së, sipas saj nuk janë respektuar kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca e GjEDNj-së (duke referuar në çështjen Volkov kundër Ukrainës), në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe paanësisë së organit që ka dhënë masën disiplinore, lidhur me:*

(i) *Përfaqësimin thelbësor të komunitetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në përbërjen e organit disiplinor. Referuar këtij kriteri, sipas subjektit të rivlerësimit, asnjë prej dymbëdhjetë*

komisionerëve të Komisionit nuk vjen nga radhët e sistemit gjyqësor në momentin e caktimit në detyrë.

(ii) *Procedurën e caktimit të anëtarëve të organit disiplinor, dhënies së garancive ndaj presioneve të jashtme.* Lidhur me këtë kriter, subjekti pretendoi se të dymbëdhjetë komisionerët e Komisionit janë zgjedhur nga një komitet parlamentar specifik *ad hoc* dhe janë caktuar nga Parlamenti pa përfshirjen e trupës gjyqësore. Sipas subjektit të rivlerësimit, formimi i Komisionit dhe, për rrjedhojë, edhe i trupës gjykuese që ka shqyrtuar çështjen e saj, bie ndesh me vendimin e GjEDNj-së të datës 12 mars 2019, lidhur me çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës*, ku sipas subjektit, GjEDNj-ja ka vendosur se shkelja e kriterëve ligjore për emërimin e anëtarëve të gjykatës së apelit, përbën shkelje të garancisë së nenit 6/1 të KEDNj-së për t'u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, e pavarur dhe e paanshme.

(iii) *Shmangien e mbivendosjes së funksioneve të ndryshme.* Subjekti pretendoi se është cenuar haptazi parimi i gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme në kushtet kur i njëjti trup gjykues ka kryer hetimin e fakteve dhe ka dhënë vendimin lidhur me gjetjet e bëra nga ai vetë.

(iv) *Kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve.* Sipas subjektit të rivlerësimit, kohëzgjatja e limituar e mandatit të anëtarëve të organeve të *vettingut*, pa mundësi riemërimi apo zgjatjeje, i bën ata veçanërisht vulnerabël nga influencat politike apo qeveritare.

24. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, se mungesa në përbërje të Komisionit e anëtarëve me prejardhje profesionale nga sistemi gjyqësor, procedura e caktimit të tyre në detyrë, si dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre cenojnë paanësinë dhe pavarësinë e trupave gjykues të tij, referuar kriterëve të përcaktuara nga jurisprudenca e GjEDNj-së⁶ për një organ disiplinor, me efekt cenimin e nenit 6 të KEDNj-së, trupi gjykues i Kolegjit mban në konsideratë faktin që Komisioni është ngritur bazuar në Kushtetutë, si një organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili do të kryejë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, sipas një procedure e cila garanton respektimin e parimeve të procesit të rregullt dhe të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit⁷.
25. Kriteret e zgjedhjes në detyrë të komisionerëve janë përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, ku referuar parashikimeve të nenit 6, pika 1, germa “ë” e ligjit, bie në sy fakti se qenia gjyqtar apo prokuror gjatë dy viteve të fundit para kandidimit, përcaktohet si kriter përjashtues në vlerësimin e kandidatave për t'u zgjedhur komisionerë. Gjithashtu, procedura e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit nga një komision parlamentar *ad hoc*, është përcaktuar në mënyrë të shprehur në kreun II të ligjit nr. 84/2016, mbi bazën e autorizimit kushtetues të nenit 179/b, pika 10 e Kushtetutës. Për më tepër, vlen të theksohet fakti që ligji nr. 84/2016 i është nënshtruar kontrollit mbi kushtetutshmërinë e tij nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, ka arsyetuar: *Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që*

⁶ Subjekti referon në ankim vendimin e GjEDNj-së për çështjen *Oleksandr Volkov v. Ukraine*.

⁷ Shih nenin 179/b, pikat 2, 5, 6, 8 dhe 10 të Aneksit të Kushtetutës.

ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Gjykata ka theksuar se me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre. Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet [...]. Gjykata Kushtetuese gjatë kontrollit të ushtruar prej saj në kuadër të vlerësimit të përputhshmërisë së parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 me Kushtetutën, nuk ka konstatuar asnjë problematikë në drejtim të përbërjes së Komisionit, me efekt cenimin e parimit të pavarësisë dhe paanësisë.

26. Duke përmbyllur analizën e mësipërme, trupi gjykues konstatoi se pretendime të njëjta me këto të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, për cenim të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së Komisionit, janë trajtuar edhe nga GjEDNj-ja, e cila në vendimin e saj lidhur me çështjen gjyqësore *Xhoxhaj k. Shqipërisë*, ka arsyetuar: [...] *Për sa i përket mospërfaqësimit të gjyqtarëve në detyrë në KPK, gjykata në fakt ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit përkatës disiplinor (shih Oleksandr Volkov, cituar më lart, paragrafi 109). Kjo nevojë është edhe më e rëndësishme në procedurat e zakonshme disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sidoqoftë, gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kishte pushtuar sistemin e drejtësisë. Ky proces përbëhet nga rivlerësimi i tri kritereve dhe ka për qëllim rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri është “sui generis” dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve. Sipas këndvështrimit të gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin (shih paragrafin 123 më lart). Ajo vëren se këta anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj (shih paragrafin 124 më lart). Për më tepër, statusi i anëtarëve të KPK-së është i njëjtë me atë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë [...]. GjEDNj-ja në vijim ka arritur në konkluzionin se nuk gjen evidencë të mungesës së pavarësisë së Komisionit, si pasojë e mospasjes në përbërje të tij të anëtarëve që vijnë nga radhët e gjyqësorit, duke mos konstatuar për rrjedhojë, shkelje të nenit 6 të KEDNj-së lidhur me sa më sipër.*
27. Sa i takon shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, se mbivendosja në të njëjtin trup gjykues e funksioneve të hetimit administrativ në lidhje me kriteret e rivlerësimit, çmimit të provave dhe vendimmarrjes lidhur me rivlerësimin kalimtar të saj, nuk përmbush standardin e gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, me pasojë cenimin e procesit të rregullt ligjor, trupi gjykues e vlerësoi këtë pretendim si të pabazuar në ligj. Trupi gjykues arriti në këtë përfundim pasi çmoi se veprimtaria e trupit gjykues të Komisionit,

kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, i cili, si më sipër cituar, i është nënshtruar edhe kontrollit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese⁸. Trupi gjykues vëren se në të njëjtin konkluzion për moscenim të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, ka arritur edhe GjEDNj-ja në çështjen gjyqësore *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*⁹, në drejtim të vlerësimit të pretendimeve të ngjashme të kërkuases lidhur me cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

28. Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka cenuar parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, duke e trajtuar atë në mënyrë të diferencuar, pasi për subjekte të tjera rivlerësi, në raste të njëjta objektive me të, Komisioni ka vendosur konfirmimin e tyre në detyrë dhe jo shkarkimin si në rastin objekt gjykimi, trupi gjykues vlerësoi se një pretendim i tillë nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar me vendimmarrje të mëparshme të tij¹⁰.
29. Lidhur me shkakun e ngritur në ankim se Komisioni nuk i ka kaluar asnjëherë subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me deklarin e rremë për kriterin e pasurisë, duke cenuar në këtë mënyrë procesin e rregullt, trupi gjykues, pasi verifikoi aktin “Rezultatet e hetimit”, me anë të të cilit i ka kaluar barra e provës subjektit të rivlerësimit mbi gjetjet e Komisionit, konstatoi se gjetjet e këtij të fundit, lidhur me dy automjetet e mëparshme të tjetërsuara (shitur, shkëmbyer) – “Mercedes Benz” me targë {***}, si dhe “Mercedes Benz” me targë {***} – janë artikulluar në drejtim të veprimeve fiktive në transaksionet e tjetërsimit të tyre, por pa i bërë me dije subjektit se në vlerësimin e Komisionit, kjo situatë faktike kualifikohet si deklarin i rremë i pasurisë. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se ndonëse pretendimi i subjektit gjendet i bazuar në fakte, për sa kohë trupi gjykues e gjeti të pabazuar konkluzionin e Komisionit për veprime fiktive në transaksionet e kryera lidhur me këto dy automjete dhe deklarin të rremë të pasurisë sipas arsyetimit në vijim¹¹, pranimi i këtij shkak ankimi u çmua se nuk ndikon në mënyrën e shqyrtimit të ankimit në Kolegj.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

30. *Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin e konstatimit të Komisionit si pasaktësi nga ana e subjektit të rivlerësimit të mosdeklarimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, të kontratës*

⁸ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.01.2017.

⁹ Shih paragrafët 307, 308 dhe 317 të të njëjtit vendim të GjEDNj-së.

¹⁰ Shih vendimet e Kolegjit nr. (JR) 33/2022, (JR) 35/2022 etj.

¹¹ Shih paragrafin nr. 48 të këtij vendimi.

së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament” me sip. 79,7 m², në rrugën “{***}”, Pogradec, të lidhur në datën 08.08.2009, trupi gjykues konstatoi si vijon.

31. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se mosdeklarimi i pasurisë objekt kontrolli në deklaratën periodike të vitit 2009, e bën këtë deklaratë të pasaktë në kuptim të pikës 5/a të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Por, duke qenë se mosdeklarimi nuk rezultoi të jetë bërë me qëllim fshehjen e pasurisë, Komisioni nuk e ka çmuar këtë pasaktësi si një shkak më vete për dhënie të masës disiplinore, por e ka vlerësuar atë në tërësinë e rrethanave të çështjes, në konsideratë edhe të pasaktësive të tjera të konstatuara për subjektin.
32. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me konkluzionin e mësipërm të Komisionit, ka parashtruar se mosdeklarimi i kontratës së shitblerjes së apartamentit në vitin 2009, është pasojë e një gabimi njerëzor (harrese) dhe se kjo kontratë ka qenë thjesht një formalizim i detyrimeve të deklaruara në këtë deklaratë periodike, duke iu referuar detyrimeve të deklaruara mbi kredinë e marrë për efekt të blerjes së apartamentit. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo kontratë ka qenë pjesë e praktikës për regjistrimin e apartamentit pranë ZVRPP-së Pogradec dhe është deklaruar rregullisht në deklaratën e pasurisë *vetting*.
33. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi fillimisht se për pasurinë objekt kontrolli (apartament banimi me sip. 79,7 m², në bashkëpronësi me bashkëshortin, me vendndodhje rruga “{***}”, Pogradec), të porositur nga subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, në vitin 2008 dhe të deklaruar rregullisht prej saj në ILDKPKI në deklaratën periodike të këtij viti, nuk rezultonte e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2009, kontrata noteriale e shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.08.2009, e lidhur para noterit Th. B., me anë të së cilës ishte fituar titulli i pronësisë mbi apartamentin e sipërcituar, në kuadër të detyrimeve për të deklaruar shtesat dhe pakësimet e pasurive sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.
34. Trupi gjykues vërejtë gjithashtu se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit e kishte deklaruar pasurinë objekt kontrolli në referim të të dhënave të kontratës së shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.08.2009, të lidhur para noterit Th. B., të cilën e kishte dorëzuar bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, në kuadër të përmbushjes së detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për paraqitjen e dokumentacionit që justifikon vërtetësinë e deklaramit të kryera. Nga verifikimi i kryer lidhur me pasurinë objekt kontrolli, në kontratën e shitblerjes, datë 08.08.2009, rezultoi se të dhënat lidhur me sipërfaqen dhe vlerën e pasurisë ishin të njëjta me ato të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ato të deklaruara në deklaratën periodike të vitit 2008, në momentin kur ishte deklaruar porositja e apartamentit. Trupi gjykues nuk konstatoi që në kuadër të kontratës së shitblerjes së datës 08.08.2009, të ishte bërë ndonjë pagesë shtesë lidhur me çmimin e apartamentit, referuar sa deklaruar më parë në deklaratën periodike të vitit 2008, para ILDKPKI-së.

35. Në analizë të sa më sipër konstatuar dhe në konsideratë të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pikat 1 dhe 2, si dhe nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se arsyetimi i Komisionit në vendim lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie, se *mosdeklarimi* [duke iu referuar kontratës së shitblerjes] e *bën këtë deklaratë* [deklaratën periodike të vitit 2009] të pasaktë në kuptim të pikës 5/a të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, është i gabuar. Në interpretimin e parashikimeve kushtetuese dhe ligjore që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë në kontekstin e procesit të rivlerësimit kalimtar, parashikimi i shprehur në nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e njërit prej elementeve thelbësore të procesit të rivlerësimit (saktësisë dhe plotësisë së deklaramit të subjekteve), i referohet deklaramit të kryer nga subjekti, lidhur me pasurinë objekt kontrolli, në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe jo në deklaratën periodike vjetore përkatëse, ndonëse vlerësimi i saktësisë së deklaratës së pasurisë *vetting* kryhet në kuadër të shqyrtimit të akteve provuese, ndër to edhe deklarimeve periodike, sipas parashikimit të legjislatorit në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuptim, referuar edhe konstatimeve në paragrafin pararendës, trupi gjykues arriti në përfundimin se mosdeklarimi i kontratës noteriale të shitblerjes së datës 08.08.2009, në deklaratën periodike të vitit 2009, edhe pse një problematikë ligjore në kuadër të mënyrës së zbatimit të detyrimeve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, nuk rezultoi të kishte prodhuar ndonjë pasojë e cila meritonte të konstatohej dhe të mbahej në konsideratë në vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.
36. Sa u takon shkaqeve të ankimit të ngritura në drejtim të kundërshtimit të konkluzioneve të arritura nga Komisioni lidhur me vlerësimin e automjeteve në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të (bashkëshortit), ndër vite, duke qenë se ato kanë shërbyer si burim për krijimin e njëri-tjetrit, trupi gjykues çmoi t’i marrë në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me to sipas rendit kronologjik të transaksioneve të kryera për këto automjete dhe jo sipas radhës së paraqitjes së shkaqeve në ankimin e ushtruar nga subjekti.
37. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues mori fillimisht në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me automjetet e mëparshme të tjetërsuara (*shitur, shkëmbyer*), konkretisht për automjetin “Mercedes Benz” të tipit “190 D”, me targë {***}, të blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në vitin 2002, në vlerën e 200.000 lekëve dhe automjetin “Mercedes Benz”, me targë {***}, të këmbyer nga ky i fundit sipas kontratës së shkëmbimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.09.2005, të lidhur para noterit Th. B., Dhoma e Noterisë Pogradec.
38. Lidhur me këto automjete, Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të këtyre pasurive të luajtshme, ka arsyetuar në vendim, ndër të tjera, si vijon.
- Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me kontratën e shitjes, datë 13.9.2005, të automjetit “Mercedes Benz” tip 190 D, me targë {***} dhe mosdeklarimin e saj. [...] Nga ana e personit të lidhur me subjektin, bashkëshorti A. T., janë kryer veprime fiktive në lidhje me automjetin “Mercedes Benz” tip 190 D, me targë {***}, me pasojë pasaktësi në deklaram, pasi në të njëjtën ditë (datë 13.9.2005), ka lidhur kontratë shitje të këtij

automjeti me shtetasin F. Ç., si dhe kontratë shkëmbimi me shtetasin G. A.. [...] Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shitjen e automjetit sipas kontratës së shitjes, datë 13.9.2005, në DIPP-në e vitit 2005. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar tatimin mbi të ardhurat për diferencën në çmim midis blerjes dhe shitjes së automjetit, prej 50.000 lekësh, në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar. Në analizën financiare është marrë në konsideratë si e ardhur nga shitja e automjetit, vetëm vlera prej 200.000 lekësh që është sa çmimi i blerjes së këtij mjeti.

▪ *Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me ekzistencën e dy kontratave të hartuara në të njëjtën ditë për të njëjtin automjet në pronësi të shtetasit A. T., përkatësisht ajo e shitjes së automjetit me targë {***}, datë 13.9.2005, në Berat, shtetasit F. Ç. dhe ajo e shkëmbimit po e datës 13.9.2008, me shtetasin G. A., në Pogradec. [...] Komisioni krijon bindjen se personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, ka kryer veprime fiktive duke lidhur dy kontrata shitblerjeje për të njëjtin automjet, konkretisht, kontratën e shitblerjes, datë 25.1.2007, me vlerë 9.000 euro, me blerësin S. Z., e cila nuk rezulton të jetë depozituar dhe regjistruar në DPSHTRr dhe kontratën e shitblerjes, datë 30.3.2008, me blerës A.B., për çmimin 2.000 euro, kontratë kjo e depozituar në DPSHTRr, por që nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP. Ky fiktivitet përforcohet edhe nga fakti se bashkëshorti i subjektit, për të njëjtin automjet, brenda një periudhe kohore prej 14 muajsh, përveçse firmos dy kontrata shitjeje, pasqyron në to një diferencë çmimi nga 9.000 euro në kontratën e datës 25.1.2007, në 2.000 euro në kontratën e datës 30.3.2008, një diferencë komplet e pajustificuar (pa dhënë asnjë arsye) për intervalin kohor kur janë firmosur këto kontrata dhe për logjikën e çmimeve në tregun e automjeteve. [...] Komisioni krijoi bindjen se nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti A. T., janë kryer veprime fiktive dhe deklarim i rremë në lidhje me automjetin tip “Mercedes Benz”, me targë {***}, pasi ky automjet është përfutur nga këmbimi, por që faktikisht subjekti dhe personi i lidhur me të nuk rezulton t’i kenë dhënë këmbyesit automjet tjetër në këmbim, pasi është shitur në po të njëjtën ditë blerësit F. Ç.. [...] Komisioni vëren se subjekti dhe bashkëshorti kanë deklaruar vetëm kontratën e shitblerjes së mjetit në datën 25.1.2007, për çmimin 9.000 euro, dhe jo kontratën e shitblerjes për të njëjtin automjet, datë 30.3.2008, për çmimin 2.000 euro, dhe kjo pasaktësi në deklarim, marrë shkas nga konsiderimi i shitjes së mjetit në datën 25.1.2007, për çmimin 9.000 euro, si veprim fiktiv, gjithashtu edhe për faktin se në DPSHTRr rezulton e regjistruar vetëm kontrata e shitblerjes së po të njëjtit mjet, për çmimin 2.000 euro, passjell marrjen në konsideratë në analizë financiare vetëm të shumës 2.000 euro.*

39. Në kundërshtimin e konkluzioneve të mësipërme të Komisionit lidhur me automjetin “Mercedes Benz” tip 190 D, me targë {***}, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar si vijon.

39.1. Automjeti “Mercedes Benz”, tip “190 D”, me targë {***}, është blerë me kontratën e datës 27.09.2002 dhe është shkëmbyer me automjetin me targë {***}, sipas kontratës së shkëmbimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.09.2005. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, nga ana e bashkëshortit të saj nuk është nënshkruar asnjë kontratë shitjeje e këtij mjeti. Ajo pretendoi gjithashtu se veprimet e vetme të kryera nga bashkëshorti i saj kanë qenë ato për shkëmbimin e automjetit, të cilat janë regjistruar edhe në DPSHTRr.

39.2. Në lidhje me ekzistencën e dy kontratave të lidhura në të njëjtën datë për këtë automjet, konkretisht një kontratë shitjeje dhe një kontratë shkëmbimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se kanë marrë dijeni vetëm pas marrjes së rezultateve të hetimit dhe se lidhur me këtë çështje, kishin ndjekur rrugën ligjore duke paraqitur kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec, provuar kjo me vërtetimin nr. {***} prot., datë 02.10.2020, të depozituar edhe në Komision.

39.3. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, pretendoi gjithashtu se Komisioni nuk kishte dhënë sqarime dhe argumente se si kishte arritur në konkluzionin për veprime fiktive. Sipas saj, Komisioni, në kuptim të parashikimeve të nenit 79 të Kodit Civil dhe vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 932, datë 22.06.2000, nuk provoi fiktivitetin dhe as nëse subjekti dhe bashkëshorti kishin pasur për qëllim të mbulonin ndonjë veprim tjetër.

40. Në lidhje me konkluzionet e Komisionit për automjetin “Mercedes Benz”, me targë {***}, subjekti i rivlerësimit parashtroi sa më poshtë.

40.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar dhe të pabazuar konkluzionin e Komisionit se: *nëse veprimi i shkëmbimit do të ishte veprim i rregullt, dosja origjinale e automjetit me targë {***} në DPSHTRr, do të ishte në emër të shtetasit G. A. meqenëse ky shtetas e ka përfituar këtë automjet me anë të shkëmbimit*, me pretendimin se procedurën për kryerjen e veprimeve për regjistrimin e mjetit apo transferimin e dosjes së automjetit e ndjek në çdo rast blerësi (përfituesi i automjetit).

40.2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, pretendoi gjithashtu se konstatimi i Komisionit lidhur me deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit sa u përket të dhënave dhe karakteristikave të mjeteve të shkëmbyera, nuk kishte relevancë në kuadër të rezultateve të hetimit lidhur me pasurinë objekt kontrolli, si dhe shpjegoi se të dhënat teknike të mjetit nuk mund të mbaheshin mend nga ana e saj, duke pasur parasysh që ajo nuk kishte qenë asnjëherë drejtuese e këtij mjeti dhe se bëhej fjalë për një periudhë të largët. Në çdo rast, subjekti pretendoi se të dhënat e automjetit janë të shënuara në certifikatën e pronësisë së mjetit dhe nuk mund të ndryshohen.

40.3. Subjekti pretendoi se Komisioni kishte mbajtur standarde të ndryshme në situata të tjera të ngjashme në lidhje me vlerësimin e shpenzimeve të cilat i kishin rritur vlerën automjetit, si dhe në rastet e shkëmbimeve të kryera të sendeve me vlera të ndryshme, duke referuar këtu rastet që u përkasin subjekteve të rivlerësimit E. LL. dhe E. I., pa identifikuar në ankim vendimet përkatëse të Komisionit apo qoftë dhe emrat e plotë të subjekteve të rivlerësimit që janë përmendur nëpërmjet inicialeve.

40.4. Në lidhje me shitjen e automjetit me targë {***}, subjekti kundërshtoi si të pasaktë konkluzionin e Komisionit për veprime fiktive në lidhje me dy kontratat e shitblerjeve të këtij automjeti dhe shpjegoi se shtetasi S. Z. ende pa bërë regjistrimin në emër të tij pranë DPSHTRr-së, të mjetit të blerë nga z. A. T., ia kishte shitur mjetin shtetasit A. B. duke i marrë *de facto* edhe çmimin e shitjes. Sipas subjektit, në kushtet kur mjeti figuronte i regjistruar në emër të

bashkëshortit të saj, për efekt të çregjistrimit të mjetit dhe regjistrimit në emër të z. B. ishte kryer një veprim formal shitjeje ku të gjitha palët e përfshira kishin qenë dakord me qëllimin e vetëm, regjistrimin e mjetit në emër të pronarit të ri.

40.5. Subjekti kundërshtoi si të gabuar dhe të pabazuar edhe konkluzionin e Komisionit në lidhje me pagesën e kështit prej 4.000 eurosh nga z. S. Z., si pasojë e transaksionit të shitblerjes së automjetit me targë {***}, duke pretenduar se Komisioni nuk kishte marrë në konsideratë as deklarin e kryer lidhur me këtë pagesë në DIPPV-në e vitit 2007 dhe as parashikimin e kontratës së shitblerjes për të cilën subjekti shprehet se është dokument ligjor me fuqi të plotë provuese sipas legjislacionit shqiptar. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky detyrim i përcaktuar në kontratë, në rast mospërmbushjeje (ndonëse për të provuar këtë pagesë, sipas subjektit, ishte mbajtur deklarata e datës 27.02.2007), bëhet i kërkueshëm mbi bazën e kontratës. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, u shpreh gjithashtu se nuk kishte arsye dhe as fakte apo prova të dyshohej për veprime fiktive lidhur me pagesën e kësaj shume, duke qenë se ajo nuk ishte deklaruar prej saj për të mbuluar një shpenzim të caktuar apo si burim për krijim pasurie. Subjekti pretendoi se deklarimi i vetëm i saj lidhur me shitjen e këtij automjeti, kishte qenë se nga shitja e tij ishte përdorur vetëm vlera prej 1850 eurosh, për blerjen e automjetit me targë {***}, deklarim ky i cili ishte marrë në konsideratë në analizën e Komisionit.

40.6. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, kundërshtoi si të pabazuar edhe konkluzionin e Komisionit se ka përfiturar nga z. G. A. një automjet pa shkëmbim dhe pretendoi se nuk ka pasur asnjë arsye të përfitohej një mjet pa shkëmbim nga ky shtetas për sa kohë as ajo, as bashkëshorti i saj, referuar verifikimeve të kryera nga Komisioni, nuk kanë pasur ndonjë lidhje direkte apo indirekte apo të ketë qenë në kushtet e konfliktit të interesit me z. G. A. në momentin e shkëmbimit të automjeteve. Gjithashtu, ajo kundërshtoi si të pabazuar në fakte dhe në ligj konkluzionin tjetër të Komisionit se gjykimi nga subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, i çështjes gjyqësore në vitin 2018, me palë ndërgjyqëse z. G. A., i cili ka rezultuar fitues, është kryer në situatë konflikti interesi të subjektit me këtë shtetas. Subjekti shpjegoi se çështja gjyqësore e sipërcituar ka përfunduar me lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, i cili ishte në favor të z. A. (dhe më pas, për të njëjtin vendim, është bërë plotësimi për shpenzimet gjyqësore, d.m.th. nuk bëhet fjalë për dy çështje gjyqësore, por për të njëjtën çështje) dhe se referuar nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, ajo nuk ka pasur asnjë lidhje apo konflikt interesi për të kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes. Sipas subjektit, veprimi juridik i shkëmbimit të mjeteve ka qenë i përfunduar 13 vite më parë, dhe megjithëse nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për pjesëmarrje në gjykim, në çdo rast edhe në aspektin kohor në kushtet kur nuk ka qenë pjesë e veprimit juridik nuk kishte si të kishte dijeni se bëhej fjalë për të njëjtin person.

41. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit lidhur me kontrollin e ushtruar mbi krijimin e dy pasurive të sipërcituara, të llojit automjet, konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
42. *Lidhur me automjetin “Mercedes Benz”, me targë {***} (me targë {***} në kohën e zhvillimit të procedurës së hetimit administrativ në Komision), trupi gjykues vëren se, referuar dosjes së këtij*

automjeti, të përcjellë zyrtarisht nga Drejtoria e Regjistrimit të Mjeteve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor¹², konstatohen të dhëna historike lidhur me këtë automjet, si më poshtë.

42.1. Kontrata noteriale e shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.09.2002, lidhur përpara noterit Th. B., me anë të së cilës z. A. T. ka blerë nga z. B. B. automjetin veturë, me targë {***}, marka “Mercedes Benz”, përkundrejt çmimit prej 200.000 lekësh. Në inventarin fizik të dosjes së këtij automjeti, është evidentuar edhe deklarata e zhdoganimit të mjetit, e cila mban datën 27.09.2002. Referuar deklaratës për zhdoganimin e automjetit, rezulton se z. A. T. ka paguar pranë autoriteteve doganore vlerën prej 151.520 lekësh, përpos çmimit të shitblerjes.

42.2. Kontrata e shitblerjes së automjetit me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.09.2005, përpara noterit L. I., sipas së cilës z. A. T. i shet z. F. Ç., banues në Berat, automjetin objekt kontrolli. Sipas parashikimit në këtë kontratë, me noterizimin e regjistrimit e kësaj kontrate, shitësi zhvishet nga pronësia mbi këtë automjet dhe pronar i tij bëhet blerësi F. Ç..

42.3. Kontrata e shitblerjes së automjetit me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.05.2006, lidhur përpara të njëjtit noter L. I., me anë të së cilës z. F. Ç. i ka shitur z. A. B., banues në Elbasan, automjetin objekt kontrolli. Në kontratë vihet re se pronësia e z. Ç. mbi automjetin objekt shitblerjeje, ndonëse referohet sipas kontratës së lidhur më datë 13.09.2005, referon gjithashtu edhe në dokumentet e automjetit të lëshuara në emër të z. A. T., në kohën kur pronësia e automjetit ishte e këtij të fundit, si: *leja e qarkullimit nr. {***}/dt. 21.10.2002 dhe certifikata e kontrollit teknik {***}, dt. 22.11.2004.*

42.4. Nga verifikimi i kryer akteve të regjistruara në dosjen e këtij automjeti, trupi gjykues konstatoi se në përgjigje të shkresës së Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Elbasan me nr. {***} prot., datë 22.05.2006, drejtuar Drejtorisë Rajonale Korçë, me lëndë “Kërkesë për transferimin e dosjes së mjetit me targë {***}”, kjo e fundit kishte përcjellë¹³ pranë Drejtorisë Rajonale Elbasan dosjen e mjetit me targë {***}. Nga të dhënat e përcaktuara në këtë shkresë, trupi gjykues vuri re se si dokument i fitimit të pronësisë së mjetit që po transferohej në Drejtorinë Rajonale Elbasan, figuronte kontrata me {***}, kredencialet e së cilës korrespondonin me ato të kontratës noteriale të lidhur përpara noterit Th. B. mes palëve B. B., në cilësinë e shitësit dhe A. T., në cilësinë e blerësit, dhe jo asaj që logjikisht duhet t’i korrespondonte, kontratës noteriale me anë të së cilës z. A. B. (blerësi) i kishte kaluar titulli i pronësisë së automjetit nga z. F. Ç. (shitësi). Rrjedhimisht dosja e mjetit rezultoi se ishte transferuar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Elbasan, pranë së cilës kishte vendbanimin blerësi nga Drejtoria Rajonale Korçë që i takonte vendbanimit të shitësit të mëparshëm dhe jo atij aktual, i cili e kishte vendbanimin në Berat, ku duhet të ndodhej edhe dosja e automjetit objekt shitjeje, sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Në vijim, në datën 08.12.2006, z. A. B. rezultoi se ishte pajisur rregullisht me lejen e re të qarkullimit të automjetit në emër të tij.

¹² Njëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 18.05.2020.

¹³ Njëpërmjet shkresës së Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë nr. {***} prot., datë 15.11.2006.

43. Lidhur me automjetin “Mercedes Benz”, me targë {***} (me targë {***}, në kohën e zhvillimit të procedurës së hetimit administrativ në Komision dhe me status çregjistrimi të përhershëm), referuar dosjes së këtij automjeti të përcjellë zyrtarisht nga Drejtoria e Regjistrimit të Mjeteve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor¹⁴, trupi gjykues konstatoi se, sipas kontratës së shkëmbimit me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.09.2005, të lidhur përpara noterit Th. B., mes z. G. A. dhe z. A. T., ky i fundit, i cili kishte në pronësi të tij një autoveturë të markës “Mercedes Benz”, me targë {***}, deklaronte se e shkëmbente atë me automjetin e llojit autoveturë të markës “Mercedes Benz”, me targë {***}, në pronësi të z. G. A.. Kjo kontratë shkëmbimi rezultoi e regjistruar rregullisht pranë DPSHTRr-së, si pasojë e së cilës në vijim, në datën 15.12.2005, z. A. T. ishte pajisur me dokumentacionin përkatës të automjetit të fituar si pasojë e shkëmbimit (certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor dhe lejen e qarkullimit). Ndërkohë që nga analizimi i akteve të dosjes së mjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, si referuar më sipër, kalimi i pronësisë së këtij automjeti në emër të z. G. A., sipas parashikimeve të kontratës noteriale të shkëmbimit të sipërcituar, nuk rezultoi të ishte regjistruar në regjistrin e automjeteve pranë DPSHTRr-së, duke bërë që ky automjet figuronte në të dhënat e organit kompetent si automjet i regjistruar në emër të z. A. T. (bashkëshortit të subjektit), deri në momentin e regjistrimit të kontratës së shitblerjes së automjetit të datës 17.05.2006, nga z. A. B., dhe transferimit të dosjes së mjetit pranë Drejtorisë Rajonale Elbasan.
44. Në dosjen e mjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, trupi gjykues konstatoi edhe regjistrimin e kontratës noteriale të shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.03.2008, të lidhur përpara noterit Th. B., sipas së cilës z. A. T. i kishte shitur z. A. B. automjetin e markës “Mercedes Benz”, me targë {***}, përkundrejt çmimit prej 2.000 eurosh. Ndërkohë që referuar DIPPV-së së vitit 2007, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar shitjen e këtij automjeti sipas kontratës së datës 25.01.2007, në shumën 9000 (nëntë mijë) euro, të ardhura këto nga të cilat shuma prej 1850 eurosh ishte deklaruar në të njëjtën deklaratë periodike vjetore, si burim për blerjen e një automjeti tjetër në po atë vit.
45. Trupi gjykues konstatoi se deklarimin e kryer në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me shitjen e automjetit të markës “Mercedes Benz”, me targë {***}, subjekti i rivlerësimit e kishte shoqëruar me kontratën noteriale të shitblerjes së automjetit me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2007, të lidhur përpara noteres E. S. K., sipas së cilës u konstatua se bashkëshorti i saj, z. A. T. kishte rënë dakord t’i shiste këtë automjet z. S. Z., përkundrejt vlerës 9000 euro, vlerë nga e cila ishte shlyer fillimisht vetëm kësti prej 5000 eurosh dhe pjesa e mbetur, kësti prej 4.000 eurosh, do të shlyhej sipas kësaj kontrate, pas një muaji.
46. Në analizë të fakteve të sipërkonstatuara, vlerësuar ato në raport me arsyetimin e dhënë në vendimin objekt kontrolli, trupi gjykues, në konsideratë edhe të legjislacionit të zbatueshëm në

¹⁴ Njëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 21.04.2020.

fushën e qarkullimit rrugor, referuar këtu parashikimeve eksplicite të neneve 90¹⁵ dhe 93¹⁶ të Kodit Rrugor, si dhe të pikës 2.18 të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 1, datë 30.01.2006, “Për sistemin e taksave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”¹⁷, arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit për veprime fiktive të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me tjetërsimin e automjeteve – “Mercedes Benz” me targë {***} dhe “Mercedes Benz” me targë {***} – është një konkluzion i cili vjen si rrjedhojë e një analize të gabuar të fakteve nga ana e Komisionit.

47. Më konkretisht, në përfundim të vlerësimit të situatës faktike lidhur me tjetërsimet ndër vite të automjetit “Mercedes Benz”, tip “190 D”, me targë {***}, trupi gjykues krijoi bindjen se ky automjet është shkëmbyer më datë 13.09.2005, sipas kontratës së shkëmbimit të lidhur në këtë datë mes z. A. T. dhe z. G. A.. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë se përgjegjësia ligjore për parregullsitë e konstatuara në mospasqyrimin e transaksioneve të kryera me këtë automjet, është e palës që fiton pronësinë e automjetit dhe se veprimet në vazhdim lidhur me automjetin dalin përtej kontrollit të palës që e humbet pronësinë e mjetit, sa kohë regjistrimi i ndryshimeve pranë DPSHTRr-së bëhet duke dorëzuar jo vetëm aktin me të cilin është fituar pronësia, por edhe dokumentacionin lidhur me mjetin, siç janë leja e qarkullimit dhe certifikata e

¹⁵ Në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 90 të Kodit Rrugor përcaktohet:

“3. Në rastet e shitjes së mjeteve me marrëveshje për t’ia rikthyer pronarit, kur nuk paguhen këstet, mjete regjistrohet në emër të blerësit, por me shënimin në lejen e qarkullimit të emrit të shitësit dhe të datës së pagimit të këstit të fundit. Të njëjtit tregues shënohen edhe në regjistrat e degës përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

4. Për efekt të shkeljeve administrative, ndaj qiramarrësit me këste të mjetit ose blerësit me këste me marrëveshje për t’ia rikthyer mjetin pronarit, kur nuk paguhen këstet, zbatohen sanksionet përkatëse sipas kapitullit VI”.

¹⁶ Në nenin 93 të Kodit Rrugor, me titull “Formalitetet për ndryshimin e pronësisë së automjeteve, motomjeteve dhe rimorkiove dhe për ndryshimin e vendbanimit të pronarit”, përcaktohet shprehimisht:

“1. Në rast ndryshimi pronësie të automjeteve, motomjeteve dhe rimorkiove ose në rastin kur i jepen në përdorim të tjerëve a kur lidhen marrëveshje për qiradhënie me të drejtë blerjeje, dega përkatëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas kërkesës së paraqitur nga ana e interesuar, brenda 10 ditëve nga data kur nënshkrimi i aktit është vërtetuar ose është gjykuar i rregullt, merr masa për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë ose të ndryshimeve të tjera, si dhe për lëshimin e certifikatës së re të pronësisë.

2. Zyra e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas kërkesës së paraqitur nga pronari brenda afateve të përcaktuara në pikën 1, merr masa për rinovimin ose azhurnimin e lejes së qarkullimit që pasqyron ndryshimet e treguara në pikën e mësipërme. Në mënyrë të ngjashme veprohet edhe për ndryshimin e vendbanimit.

3. Cilido që nuk respekton dispozitat e përcaktuara nga ky nen, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga dhjetë mijë deri në dyzet mijë lekë.

4. Cilido që qarkullon me një mjet, për të cilin nuk është kërkuar, brenda afatit të caktuar në pikën 1 dhe 2, azhurnimi ose rinovimi i lejes së qarkullimit dhe i certifikatës së pronësisë, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë.

5. Leja e qarkullimit i merret menjëherë atij që kryen shkeljet e parashikuara në pikën 3 dhe i dërgohet zyrës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që merr masa për rinovimin e saj pas zbatimit të dispozitave që janë shkelur”.

¹⁷ Në pikën 2.18, “Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e luajtshme (automjete)”, të këtij udhëzimi, në kohën e transaksioneve objekt kontrolli përcaktohej:

“Për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë të pasurive të luajtshme (automjetet) ngarkohen Drejtoritë Rajonale të Transportit Rrugor. Kjo taksë aplikohet për çdo ndryshim të pronësisë së mjeteve. Taksa e kalimit të pronësisë vilet në momentin kur dokumenti i kalimit të pronësisë (me aktin noterial të shitjes, dhurimit e të tjera të ngjashme me to) paraqitet për veprim në Drejtorinë Rajonale të Transportit Rrugor për pajisjen me lejen e re të qarkullimit të mjetit. Pronari i ri, përveç dokumentacionit që nevojitet për të legalizuar kalimin e së drejtës së pronësisë, paraqet edhe një kopje të noterizuar të kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë [...]”.

pronësisë së mjetit, akte këto të dorëzuara pronarit të ri të mjetit, së bashku me automjetin. Në kuptim të sa më sipër, referuar akteve të administruara në dosjen e mjetit objekt kontrolli pranë DPShTRr-së, rezultoi se nuk ishte regjistruar rregullisht as kontrata e shkëmbimit me z. G. A. dhe as kontrata e shitblerjes e së njëjtës datë, e lidhur mes z. T. dhe z. F. Ç., për sa kohë që kontrata e shitblerjes në vijim, nga z. Ç. te z. B., rreth 1 vit më vonë referonte në dokumentacionin e automjetit ende në emër të z. T., edhe pse, referuar konkluzionit të Komisionit se ky automjet i ishte shitur z. Ç., do duhej që mjeti të ishte regjistruar në emër të këtij të fundit. Rrjedhimisht, edhe dosja e automjetit duhet të ishte transferuar në Drejtorinë Rajonale Berat dhe jo të kalonte nga Drejtoria Rajonale Korçë në Drejtorinë Rajonale Elbasan. Në vlerësimin e trupit gjykues, sa më sipër konstatuar duhet t'i kishte shërbyer Komisionit në funksion të bërjes së një analize më të plotë, faktike dhe ligjore, lidhur me vlerësimin e ekzistencës dhe vërtetësisë së kontratës së shitblerjes mes z. T. dhe z. Ç. në datën 13.09.2005, si dhe të shkresës së Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Berat me nr. {***} prot., datë 02.11.2005, drejtuar Drejtorisë Rajonale Korçë, me lëndë “Kërkesë për transferimin e dosjes së mjetit me targë {***}”, për sa kohë rezultoi që këto akte, edhe pse ndodheshin fizikisht në dosjen e automjetit, nuk kishin prodhuar asnjë pasojë juridike të pritshme referuar legjislacionit të zbatueshëm në fuqi (ndryshimi i pronësisë së automjetit nga z. T. te z. Ç., ndryshimi i lejes së qarkullimit të mjetit, ndryshimi i certifikatës së pronësisë së mjetit, si dhe transferimi i dosjes së mjetit nga njëra drejtori rajonale në tjetrën, referuar vendbanimit të pronarit të ri). Në kuadër të kësaj analize juridike të fakteve të konstatuara, si pasojë e shqyrtimit të dokumentacionit të administruar nga organi shtetëror kompetent, lidhur me regjistrimin e automjeteve në qarkullim në Republikën e Shqipërisë, trupi gjykues krijoi bindjen mbi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, se e vetmja kontratë e lidhur mes bashkëshortit të subjektit dhe z. G. A. ishte ajo për shkëmbimin e automjeteve, pa qenë e nevojshme marrja e provave të reja të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, sipas të cilave rezultonte se kontrata e shitblerjes e datës 13.09.2005, e lidhur mes z. A. T. dhe z. G. A., ishte e falsifikuar.

48. Në vijim të këtij konkluzioni, trupi gjykues konstatoi se konkluzioni i Komisionit lidhur me automjetin “Mercedes Benz”, me targë {***}, se nga ana e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit janë kryer veprime fiktive dhe deklaram i rremë në lidhje me këtë automjet, është i pabazuar për sa kohë ky konkluzion i Komisionit është mbështetur në arsyetimin se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk rezultuan t'i kenë dhënë këmbyesit, z. G. A., automjetin me targë {***} në këmbim, pasi ai i ishte shitur në po të njëjtën ditë blerësit F. Ç. sipas kontratës përkatëse të shitblerjes të lidhur më datë 13.09.2005, dokument ky i cili, sipas vendimit gjyqësor, rezultoi i falsifikuar. Trupi gjykues vëren gjithashtu se Komisioni nuk ka qenë i qartë në qëndrimin e tij në lidhje me raportin mes dy kontratave të shitblerjes së automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, të lidhura respektivisht më datë 25.01.2007 mes z. T. dhe z. S. Z., dhe më datë 30.03.2008 mes z. A. T. dhe z. A. B., pasi nga njëra anë duket sikur kontratën e parë, të lidhur më 25.01.2007, Komisioni e vlerëson si veprim fiktiv vetëm në lidhje me përcaktimin në kontratë të çmimit të shitjes prej 9000 eurosh, ndërkohë që në përfundim ka arritur në konkluzionin se shitja e automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, është kryer sipas kontratës së shitblerjes të lidhur më datë 30.03.2008, dhe se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë me mosdeklarimin e kësaj kontrate në

deklarimin periodik vjetor para ILDKPKI-së. Rrjedhimisht, edhe në analizën financiare të kryer, shitjen e automjetit e ka marrë në konsideratë sipas kësaj kontrate dhe jo asaj të lidhur më datë 25.01.2007.

49. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, si dhe bazuar në parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm në fuqi, trupi gjykues çmon se lidhja e kontratës së shitblerjes më datë 25.01.2007, mes z. A. T. dhe z. S. Z., detyronte këtë të fundit të kryente veprimet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor përkatëse, duke bërë regjistrimin e kontratës së shitblerjes dhe ndryshimin e dokumentacionit të automjetit sipas parashikimeve të nenit 90 të Kodit Rrugor, edhe pse referuar kontratës së shitblerjes, mjeti mund t'i kthehej z. T. nëse nuk paguhej kësti i fundit. Në kuptim të sa më sipër, si me të drejtë pretenduar edhe nga subjekti i rivlerësimit, përgjegjësia për moskryerjen e veprimeve pranë organit kompetent bie mbi palën blerëse dhe jo bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, i cili paraqitet në cilësinë e palës shitëse. Trupi gjykues, në një vlerësim tërësor të rrethanave lidhur me kryerjen e këtyre transaksioneve, ndonëse vlerësoi se një rritje e vlerës në shitje e automjetit, me kalimin e viteve, krahasuar me vlerën e tij fillestare, nuk mbështetet në logjikën ekonomike, në mungesë të rrethanave të tjera të cilat do të krijonin qoftë edhe në dukje, një justifikim për mbulimin e një veprimi tjetër juridik apo do të çmoheshin se i shërbenin një qëllimi të caktuar të subjektit dhe/ose personit të lidhur me të, për të paraqitur *de jure* një çmim më të lartë shitjeje, si nevojë për mbulimin e transaksioneve të tjera për krijim pasurie, në kuadër të justifikimit të ligjshmërisë së burimeve të përdorura, çmon se në rastin objekt gjykimi, objektivisht nuk krijohet dyshimi i arsyeshëm për një veprim juridik ku çmimi i shitblerjes të ketë qenë fiktiv. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues çmoi edhe faktin se pranimi i çmimit të shitblerjes së automjetit, prej 9000 eurosh, sipas kontratës së datës 25.01.2007, sillte një efekt të papërfillshëm në përmirësimin e rezultatit financiar të vitit 2007, referuar analizës së Komisionit, me një korrektim të rezultatit negativ me vetëm 65.178 lekë, duke rezultuar pjesa më e madhe e kësaj të ardhure si një tepriceë pozitive në analizën e këtij viti, edhe në eventualitetin e përfshirjes së një shpenzimi të pallogaritur nga Komisioni sipas arsytimit në paragrafët vijues¹⁸.
50. Në vijim të analizës së mësipërme faktiko-juridike, trupi gjykues çmoi se veprimi juridik me anë të të cilit z. T. ka humbur pronësinë e automjetit “Mercedes Benz”, *me targë {***}*, është kontrata e shitblerjes e lidhur më datë 25.01.2007, mes z. A. T. dhe z. S. Z., dhe jo ajo e lidhur mes tij dhe z. A. B. më datë 30.03.2008. Përveç sa më sipër arsyetuar, në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe faktin se nga hetimi i kryer në Komision, nuk kishte rezultuar ndonjë provë apo ndonjë e dhënë në drejtim të përdorimit të automjetit objekt kontrolli nga z. T. në harkun kohor 25.01.2007 deri më 30.03.2008, çka mund të ngrinte dyshime të arsyeshme në drejtim të lidhjes së një kontrate shitblerjeje fiktive në janar të vitit 2007. Në vijim të kësaj analize, trupi gjykues e gjeti bindës shpjegimin e subjektit të rivlerësimit se kontrata e lidhur në vijim me z. A. B., kishte qenë një veprim formal i cili i kishte shërbyer vetëm qëllimit për të realizuar çregjistrimin e mjetit nga z. A. T., i cili figuronte ende pronar i mjetit në regjistrin kombëtar të

¹⁸ Shih arsyetimin në paragrafin nr. 61, në këtë vendim.

automjeteve në qarkullim në Republikën e Shqipërisë dhe regjistrimin e tij në emër të z. B., si pronar faktik i tij.

51. Në lidhje me shkakun e ngritur në ankim për kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit se: *gjkimi i çështjes gjyqësore në vitin 2018, nga subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, me palë ndërgjyqëse G. A., i cili ka rezultuar fitues, marrë për bazë nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile¹⁹, është kryer në situatë konflikti interesi të subjektit me këtë shtetas sepse, sipas rrethanave konkrete, vërtetohen arsye serioze njëanshmërie – trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe kontrollit të arsyetimit të Komisionit, referuar fakteve të provuara gjatë hetimit dhe zbatimit të parashikimeve ligjore lidhur me to, vlerëson se marrëdhënia e interesit së cilës i referohet Komisioni, mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe z. G. A., që ka lindur si pasojë e marrëdhënies juridike të shkëmbimit të automjeteve në vitin 2005, është një marrëdhënie e përfunduar, nga e cila nuk rezulton të ketë lindur ndonjë mosmarrëveshje mes palëve, e cila të ishte prezente në kohën e përfshirjes së subjektit të rivlerësimit në gjykimin e çështjes gjyqësore objekt kontrolli (në vitin 2018) dhe, si e tillë, nuk përmbush kriteret për ta vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e parashikimit ligjor të ekzistencës së rrethanave konkrete sipas të cilave vërtetohen arsye serioze njëanshmërie, rast ky për të cilin subjekti i rivlerësimit do duhej të deklaronte heqjen dorë sipas përcaktimit të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Për rrjedhojë, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, në vlerësim të trupit gjykues, gjykimi i kësaj çështjeje nga subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, nuk është kryer në situatë konflikti interesi të subjektit se kjo e fundit nuk ka pasur detyrim ligjor për të hequr dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, në kuadër të parashikimeve të dispozitës së sipërcituar të Kodit të Procedurës Civile.*
52. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të bazuar në fakte dhe në ligj shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe çmon se në kuadër të verifikimit të saktësisë dhe plotësisë së deklaramentit, duke mos qenë në kushtet e detyrimit për deklarament të pasurive të cilat nuk janë në pronësi, zotërim apo posedim në momentin e plotësisë së deklaramentit të pasurisë *vetting*, verifikimi i saktësisë së deklaramenteve lidhur me këto dy automjete të tjetërsuara në vitet 2005 dhe 2007, kryhet vetëm në raport me pasojat që kanë sjellë veprimet juridike për këto automjete në analizën financiare të viteve kur kanë ndodhur këto veprime.
53. *Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit “automjet” të tipit “Ford Mondeo”, vit prodhimi 2006, me targë {***}, të blerë në vitin 2013, në vlerën e 4.000 eurove, për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë konkluzionin e Komisionit lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit të mëparshëm të tipit “Mercedes Benz”, me targë {***}, të cilat ishin deklaruar si burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
54. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramentit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit të

¹⁹ Neni 72 i Kodit të Procedurës Civile, “Rastet e përjashtimit të gjyqtarit”, parashikon në pikën 1 se gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje kur: “ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë gjykim”; dhe pika 6: “në çdo rast tjetër kur vërtetohen sipas rrethanave konkrete arsye serioze njëanshmërie”.

tipit “Ford Mondeo”, me targë {***}, me burim të deklaruar të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, ka arritur në konkluzionin se lidhur me këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, nuk ka paguar tatimin për diferencën në çmim midis blerjes dhe shitjes së mjetit, prej 1.650 eurosh, në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar, duke marrë në konsideratë si të ardhur nga shitja e këtij automjeti, vetëm vlerën prej 1.850 eurosh që i takon çmimit të blerjes së tij.

55. Bazuar në konkluzionin e mësipërm të Komisionit, duke qenë se vlerësimi i ligjshmërisë së krijimit në vitin 2013, i pasurisë automjet i tipit “Ford Mondeo”, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga shitja në vitin 2013, e një tjetër automjeti në pronësi të subjektit të rivlerësimit, të tipit “Mercedes Benz”, me targë {***}, trupi gjykues çmoi të analizojë në mënyrë të integruar shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e të dy këtyre automjeteve.
56. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues vëren se në lidhje me automjetin e markës “Mercedes Benz”, me targë {***}, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për veprime të pajustificueshme të blerjes dhe shitjes së këtij automjeti nga bashkëshorti, z. A. T., duke shpjeguar se çmimi i blerjes dhe shitjes së këtij automjeti është caktuar nga tregu dhe jo nga ndonjë faktor tjetër.
57. Ndërkohë që Komisioni, në përfundim të verifikimit të kryer lidhur me saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, bashkëshorti A. T., janë kryer veprime të pajustificueshme financiare të blerjes dhe shitjes së automjetit të tipit “Mercedes Benz”, me targë {***}, referuar fillimisht blerjes së automjetit në vitin 2007 në një çmim prej 1.850 eurosh, të cilin e ka vlerësuar si fiktiv dhe, në vijim, shitjes së tij në vitin 2013 me një rritje në çmim që kap vlerën totale të 3.500 eurove, duke e vlerësuar këtë si veprim financiar të pajustificuar. Gjithashtu, Komisioni ka vlerësuar se për sa kohë subjekti nuk ka paguar tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga diferenca midis çmimit të blerjes dhe shitjes së automjetit të tipit “Mercedes Benz”, me targë {***}, në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, në analizën financiare të vitit 2013, i ka marrë në konsideratë, si të ardhur nga shitja e këtij automjeti, vlerën deri në masën e çmimit të blerjes, prej 1.850 eurosh, e cila është përlllogaritur si burim për blerjen në po të njëjtin vit, të automjetit të tipit “Ford Mondeo”, me targë {***}.
58. Nga shqyrtimi i shkaqeve të ankimit lidhur me këto dy automjete, trupi gjykues, pasi verifikoi fillimisht aktet e fashikullit të çështjes, në mënyrë të veçantë dosjen e automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, të përcjellë nga DPSHTRr-ja, konstatoi se përfundimi i arritur nga Komisioni për veprime fiktive të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në përcaktimin e çmimit të blerjes së këtij automjeti, bazuar në arsyetimin se shitësi (z. F. Ç.) vetëm pas tri ditësh nga pagesa e detyrimit doganor ia kishte shitur automjetin, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. A. T., me një humbje prej 168.342 lekësh, është konkluzion i pabazuar në fakte të provuara.

59. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen e mjetit të sipërcituar, konkretisht: (i) “kontratës për shitje makine”, të lidhur më datë 16.05.2007, mes z. A. T. dhe z. F. Ç., para noterës publike B. S. K., me nr. {***} rep., nr. {***} kol.; (ii) akteve “Vërtetim-Hyrje”, të lëshuara respektivisht nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë, Pika e Kalimit të Kufirit Qafë Tushemisht²⁰ dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Dogana e Tushemishtit, sipas të cilave rezultoi se automjeti në pronësi të z. F. Ç. kishte hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë në datën 15.05.2007; (iii) “Deklaratës doganore” me nr. S. R. {***}, që mban datën 17.05.2007, ku rezulton të jetë pasqyruar edhe vlera e shitjes së automjetit sipas çmimit të përcaktuar, prej 1850 eurosh, në kontratën e shitblerjes së datës 16.05.2007²¹; si dhe (iv) mandatpagesës me numër serial {***}, të urdhëruar nga z. A. T., me përfitues “Dogana Pogradec” për zhdoganim veture në vlerën e 224.978 lekëve, e cila mban datën 17.05.2007, dhe jo datën 13.05.2007, sikundër përmend Komisioni në vendim – trupi gjykues konstatoi një situatë faktike të ndryshme nga ajo e referuar nga Komisioni në vendim, sa i takon dinamikës së veprimeve lidhur me blerjen nga z. A. T. të automjetit të markës “Mercedes Benz”, me targë {***}, sipas së cilës rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, pas pagesës së çmimit të blerjes së automjetit prej 1850 eurosh, ka paguar edhe detyrimin përkatës pranë autoriteteve doganore për zhdoganimin e automjetit të sapoblerë, në vlerën e 224.978 lekëve, duke rezultuar me një shpenzim total prej 456.987 lekësh për blerjen e këtij automjeti, dhe jo 232.008 lekë sa përlllogaritur nga ana e Komisionit.
60. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues, pasi vlerësoi të pabazuar konkluzionin e Komisionit se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kryer veprime fiktive lidhur me përcaktimin e çmimit të blerjes së automjetit, çmoi po ashtu të pabazuar edhe konkluzionin që i atribuohet bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për veprim financiar të pajustificuar në përcaktimin e çmimit të shitjes së këtij automjeti në vitin 2013, në vlerën e 3500 eurove (konvertuar në 490.700 lekë), sa kohë ky përfundim kishte ardhur si pasojë e një vlerësimi të gabuar të fakteve të cilat e kishin orientuar Komisionin drejt një rezultati të pasaktë të vlerës së investuar fillimisht për blerjen e automjetit dhe, në vijim, në konkluzionin mbi shitjen e automjetit me një fitim të realizuar në shumën e 1650 eurove, ndërkohë që referuar fakteve, rezultoi se automjeti ishte shitur me një vlerë prej 145 eurosh më të ulët se vlera e shpenzuar për blerjen e tij [3500²² – (1850 euro²³ + 1795 euro²⁴)].
61. Në vijim të arsyetimit si më sipër në vendim²⁵, lidhur me shitjen e automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, në datën 25.01.2007, dhe të ardhurat e krijuara nga ky transaksion, një pjesë e të cilave ishin deklaruar si burim krijimi për blerjen në datën 16.05.2007, të automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, trupi gjykues, pasi kontrollloi analizën e kryer nga Komisioni, konstatoi

²⁰ Me nr. {***} regj., datë 17.05.2007, sipas së cilës vërtetohet se automjeti “Benz”, veturë, me numër shasie {***}, me targë regjistrimi të shtetit përkatës {***} dhe pronar z. F. Ç., ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë në datën 15.05.2007, në Tushemisht.

²¹ Shih rubrikën nr. 22 të “Deklaratës doganore”.

²² Çmimi i shitjes së automjetit sipas kontratës së datës 31.07.2013.

²³ Çmimi i blerjes së automjetit sipas kontratës së datës 16.05.2007.

²⁴ Konvertimi në euro i vlerës së paguar për zhdoganimin e automjetit në masën e 224.978 lekë, sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë të datës së zhdoganimit të automjetit prej 125.36 lekë/1 Euro.

²⁵ Shih paragrafët nr. 48 e në vijim të këtij vendimi.

se, edhe në eventualitetin e përfshirjes në zërin e shpenzimeve të pagesës së kryer për zhdoganimin e tij në shumën prej 224.978 lekësh, të cilën Komisioni nuk ia kishte atribuar si shpenzim personit të lidhur, arriti në konkluzionin se përsëri bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit kishte pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, dhe mbulimin e shpenzimeve gjatë vitit 2007, duke rezultuar me një bilanc financiar pozitiv prej 798.034 lekësh për këtë vit.

62. Në vijim të analizës lidhur me shqyrtimin e shkakut të ankimit për kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit lidhur me vlerësimin e automjetit të tipit “Ford Mondeo”, trupi gjykues vlerësoi se për sa kohë nuk ka asnjë pretendim në drejtim të situatës faktike lidhur me krijimin e kësaj pasurie, e vetmja çështje që ngrihet për diskutim, është vlerësimi juridik mbi përfshirjen apo jo të shumës prej 1650 eurosh, pjesë e çmimit të shitjes së automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, si të ardhur të ligjshme në analizën financiare të vitit 2013, për blerjen e automjetit objekt kontrolli (automjetit të tipit “Ford Mondeo”, me targë {***}), duke qenë se si konstatuar nga ana e Komisionit, për këto të ardhura të cilat ishin deklaruar si burim për financimin e blerjes së këtij automjeti, nuk ishte provuar pagesa e detyrimit tatimor mbi diferencën mes çmimit të shitjes dhe atij të blerjes, në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar.
63. Në dritën e fakteve të konstatuara më sipër në vendim, sipas të cilave rezultoi se në kuadër të shtimit të pasurisë së tij me blerjen e automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, në vitin 2007, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit kishte kryer edhe një shpenzim për zhdoganimin e automjetit në vlerën e 224.529 lekëve, referuar “Deklaratës doganore” nr. {***}, datë 17.05.2007, dhe mandatpagesës me numër serial {***}, datë 17.05.2007, të urdhëruar prej vetë atij, e cila u çmua nga trupi gjykues si vlerë e shpenzuar për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2007, diferenca e konstatuar nga Komisioni, në vlerën prej 1650 eurosh, mes çmimit të blerjes së automjetit në vitin 2007 dhe çmimit të shitjes në vitin 2013, në vlerësimin e trupit gjykues nuk përbën fitim të realizuar nga shitja e automjetit, duke qenë se automjeti rezultoi të ishte shitur në kosto.
64. Përpos sa më sipër, lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga shitja e automjetit objekt kontrolli, referuar çmimit të shitjes së tij në vlerën e 3500 eurove, në kuadër të standardit kushtetues të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues, bazuar edhe në parashikimin e nenit 155 të Kushtetutës²⁶, çmoi se ndryshimi që ka pësuar ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”²⁷, me shtimin në nenin 8 të tij që përcakton të ardhurat e tatueshme, të paragrafit “g”, me përmbajtje: *të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë* – nuk duhet t’i nënshtrohet një interpretimi të zgjeruar, me rezultat përcaktimin e detyrimit për pagesën e tatimit për të ardhurat e krijuara nga transaksionet e shitblerjeve të automjeteve në kushtet e mungesës së rregullimit në mënyrë të

²⁶ Neni 155 i Kushtetutës përcakton: “Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Në këto raste, ligjit nuk mund t’i jepet fuqi prapavepruese”.

²⁷ Me miratimin e ligjit nr. 9161, datë 18.12.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”.

posaçme në ligj të shkallës tatimore, përcaktimit të bazës së tatueshme, mënyrës së pagesës dhe agjentit tatim mbledhës.

65. Për rrjedhojë, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit në shqyrtimin e qëndrimeve të ngjashme të Komisionit lidhur me vlerësimin e çështjes së mospagimit të detyrimeve tatimore në lidhje me të ardhurat e krijuara nga shitblerja e automjeteve²⁸, trupi gjykues vlerësoi të konsiderojë të ligjshme të ardhurat e krijuara prej shitjes së automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}, sipas çmimit kontraktual të shitjes prej 3500 eurosh dhe, rrjedhimisht, ta përfshijë atë si të ardhur të ligjshme në analizën financiare të kryer për efekt të vlerësimit të burimeve të krijimit të automjetit të tipit “Ford Mondeo”, të blerë në vitin 2013.
66. *Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit automjet të tipit “Fiat Lancia”, me vit prodhimi 1999, me targë {***}, blerë në vitin 2015 dhe shitur në vitin 2016, për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja e kësaj pasurie, si dhe rezultatin negativ të analizës financiare të vitit në të cilin është tjetërsuar kjo pasuri, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
67. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramentit dhe ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga shitja e automjetit të sipërcituar, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar tatimin mbi të ardhurat për diferencën midis blerjes dhe shitjes së mjetit, në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar. Për rrjedhojë, Komisioni në analizën financiare të vitit 2016, bazuar në sa më sipër, ka marrë në konsideratë si të ardhur nga shitja e automjetit vetëm vlerën prej 800 eurosh, që është çmimi i blerjes së automjetit, duke afektuar analizën financiare për vitin 2016, që rezulton me një balancë financiare negative në shumën prej 386.760 lekësh.
68. Në mbështetje të shkakut të ankimit për konkluzion të gabuar nga ana e Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë automjet të tipit “Fiat Lancia”, me targë {***}, subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendimet e mëposhtme.
 - (i) Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, pretendoi se rezultati i analizës financiare të kryer nga Komisioni lidhur me krijimin e kësaj pasurie në vitin 2015, është i gabuar pasi, sipas saj, nuk janë marrë në konsideratë kursimet familjare të viteve paraardhëse, pjesë e të cilave ka qenë edhe vlera prej 1.000 USD, të dhuruara nga motra e bashkëshortit, si dhe nuk është llogaritur huaja e marrë nga z. S. K. në vlerën prej 8.000 eurosh.
 - (ii) Në lidhje me tatimin për vlerën prej 200 eurosh, të përfituar nga shitja e automjetit, për të cilën Komisioni ka konstatuar që nuk janë përmbushur detyrimet tatimore përkatëse, subjekti pretendoi se kjo shumë nuk përbën fitim dhe, për pasojë, nuk bën pjesë në të ardhurat e tatueshme referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, të ndryshuar. Subjekti pretendoi se vlera prej 200 eurosh është përdorur për mirëmbajtjen e mjetit dhe se duke mos qenë detyrim ligjor për t’u deklaruar në deklaramentet periodike përkatëse, ky shpenzim nuk është deklaruar prej saj.

²⁸ Shih vendimet e Kolegjit nr. 26/2023 (JR) parag. 12.5, nr. 32/2023 (JR) etj.

(iii) Balanca negative e konstatuar nga Komisioni për vitin 2016, sipas subjektit të rivlerësimit, vjen si rrjedhojë e keqlllogaritjeve të shpenzimeve për hyrje-daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë.

69. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues konstatoi fillimisht se vlerësimi i pasurisë së luajtshme të llojit automjetit i tipit “Fiat Lancia”, është kryer në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, me burim shitjen e automjetit të sipërcituar. Komisioni, ndonëse në analizën e kryer për verifikimin e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit në vitin 2015, ka arritur në përfundimin se në momentin e blerjes së automjetit në datën 2.9.2015, me burim krijimi kursimet nga të ardhurat bashkëshortore, subjekti ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme, në përfundim, në analizën financiare të vitit 2016, e ka përlllogaritur si të ardhur të ligjshme vlerën prej 800 eurosh, që përfaqësonte çmimin e blerjes së automjetit në vitin 2015.
70. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me rezultatin e analizës financiare të vitit 2015 dhe, në mënyrë të veçantë, në lidhje me përlllogaritjen e vlerës së kursimeve familjare të përdorura për blerjen e automjetit, si derivat i pretendimeve lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit, sipas sistemit TIMS, përdorimit apo jo të huasë së dhënë nga z. S. K., në vlerën e 8.000 eurove, si dhe dhurimit të një vlere monetare prej 1.000 dollarësh nga motra e bashkëshortit, konsiderohen të panevojshme për t’u marrë në analizë nga trupi gjykues në drejtim të efektit që passjellin këto pretendime në vlerësimin e ligjshmërisë së burimeve në blerje të automjetit të shitur në vitin 2016, për sa kohë Komisioni e ka marrë në konsideratë si të ardhur të ligjshme vlerën e blerjes prej 800 eurosh.
71. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerësimin si të ardhur të ligjshme të shumës prej 200 eurosh, që përfaqëson diferencën në vlerë mes çmimit në shitje dhe blerje të automjetit të tipit “Fiat Lancia”, trupi gjykues vlerësoi të mbajë të njëjtin qëndrim si më sipër në vendim²⁹, mbi vlerësimin si të ligjshme të të ardhurave të krijuara nga shitja e automjetit sipas çmimit të shitjes, për sa kohë ato nuk janë njohur si të tilla nga Komisioni vetëm bazuar në arsyetimin për mos mospagesë të detyrimeve tatimore bazuar në përcaktimet ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar.
72. *Lidhur me shkakun e ngritur në ankim për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit lidhur me dhënien e një huaje në shumën 8000 euro bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga z. S. K., sipas kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.01.2015, dhe të depozituar pranë Bankës Societe Generale Albania, për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka paraqitur prova të mjaftueshme sipas të cilave vërtetohet mundësia e huadhënësve për të justifikuar me burime të ligjshme krijimin e shumës së dhënë hua nga z. K., në vlerën prej 8.000 eurosh, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, në kuadër të vlerësimit të kësaj huaje në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës*

²⁹ *Shih arsyetimin lidhur me vlerësimin mbi ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga shitja e automjetit “Mercedes Benz”, me targë {***}.*

dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, ndonëse është shprehur se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor burimin e të ardhurave të realizuara në shumën e 8.000 eurove nga shtetasi S. K., duke qenë se kjo shumë e depozituar në llogarinë bankare është përdorur në një pjesë të vogël nga subjekti i rivlerësimit dhe, më pas, i është kthyer huadhënësit brenda vitit, e ka vlerësuar këtë hua pa ndikim në analizën financiare të vitit 2015.

73. Bazuar në arsyetimin e mësipërm të Komisionit, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë që konkluzioni i Komisionit për mosjustifikim të burimeve të ligjshme për dhënien e huasë, nuk ka prodhuar asnjë pasojë në dëm të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, qoftë në drejtim të mosjustifikimit të pasurisë të saj, qoftë në drejtim të efektit në analizën financiare të periudhës së rivlerësimit, trupi gjykues çmoi se ky shkak ankimi nuk ka ndikim në vlerësimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe, rrjedhimisht, bazuar në parimin e ekonomisë gjyqësore, analizimi i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit mbi vlerësimin e burimeve të ligjshme financiare të z. S. K., për dhënien e huasë, u çmua i panevojshëm.
74. *Lidhur me zotërimin nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të (bashkëshortit) të aksioneve në shoqërinë “{***}” ShA, secili nga 50 aksione gjithsej, me vlerë 50.000 lekë ose 0,00027% e kapitalit, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
75. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, ndodhet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm lidhur me faktin e zotërimit prej saj dhe personit të lidhur (bashkëshortit) të aksioneve të shoqërisë “{***}” ShA. Komisioni, këtë konkluzion e ka mbështetur në arsyetimin se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë fakt në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, pavarësisht vlerës së vogël të këtyre aksioneve, si dhe referuar nenit 3 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, subjekti ndodhej në situatën e konfliktit të interesit dhe, për rrjedhojë, konform dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, që parashikojnë rastet e heqjes dorë të gjyqtarit nga gjykimi i çështjeve gjyqësore, duhej të kishte deklaruar heqjen dorë nga gjykimi i çështjeve gjyqësore ku shoqëria “{***}” ShA ka qenë palë.
76. Në mbështetje të shkakut të ankimit për konkluzion të gabuar të Komisionit lidhur me zotërimin e këtyre aksioneve, subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, ka pretenduar se mosdeklarimi prej saj i zotërimit të aksioneve të shoqërisë “{***}” ShA, vjen si rezultat i mosqenies në dijeni të regjistrimit të këtyre aksioneve në regjistrin tregtar. Subjekti shprehet se blerja e aksioneve nëpërmjet depozitimit të letrave me vlerë prej 50.000 lekësh, e përkthyer në pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë në vlerën 0,00027%, ka ndodhur në vitin 2009 dhe pa qenë të qartë për regjistrimin e tyre apo pjesën takuese. Sipas subjektit të rivlerësimit, ata (subjekti dhe bashkëshorti) asnjëherë nuk kanë përfutuar ndonjë të ardhur në formën e dividendit, çka ka krijuar idenë se mbledhja e letrave me vlerë në vitin 2009, sipas saj, ka qenë një formalitet dhe jo me qëllim futjen si aksionerë të punonjësve të “{***}”-it. Subjekti shpjegoi gjithashtu se, duke mos qenë në dijeni të faktit të regjistrimit të aksioneve në regjistrin tregtar, ka menduar se kjo marrëdhënie është përfunduar në disfavor të punëmarrësit që me përfundimin e marrëdhënies së

punësimi të bashkëshortit të saj nga punëdhënësi (“{***}” ShA), në vitin 2013. Subjekti i rivlerësimit argumentoi se deri në momentin që bashkëshorti ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “{***}” ShA, ka hequr dorë nga të gjitha çështjet gjyqësore që ka pasur në gjykim nisur vetëm nga fakti që bashkëshorti ka qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie.

77. Në shqyrtim të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se, referuar informacionit të përcjellë nga Qendra Kombëtare e Biznesit³⁰, konfirmohet fakti i pranuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, se kjo e fundit dhe bashkëshorti i saj, z. A. T., janë *aksionerë me 0,00027% të aksioneve në shoqërinë “{***}” ShA*. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se në kuptim të detyrimeve që përcakton neni 4, pika 1, shkronja “ç” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, si dhe neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për t’i deklaruar këto aksione në deklarin periodik të vitit 2009, që përkon me vitin e blerjes së aksioneve, si dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Ndonëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me arsyet e mosdeklarimit të këtyre aksioneve, çmohen të besueshme edhe për faktin që nga verifikimi që mund të kryejë çdo qytetar në regjistrin tregtar nga platforma elektronike e Qendrës Kombëtare të Biznesit, fakti i të qenit aksioner pranë shoqërisë tregtare “{***}” ShA, vlera e aksioneve të zotëruara dhe përqindja e pjesëmarrjes në kapitalin e kësaj shoqërie, është i pamundur për t’u verifikuar nëpërmjet një kontrolli të zakonshëm, për arsye teknike që lidhen me numrin e madh të “aksionerëve të tjerë persona fizikë, me një përqindje totale në vlerë prej 3,4478%” (rreth 7000), si konfirmuar edhe nga vetë QKB-ja në komunikimin e saj me Komisionin, përcaktimi me ligj i një detyrimi për deklarin të zotërimit të kësaj pasurie, vlerësohet nga trupi gjykues se duhet ta kishte vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e një kujdesi dhe vigjilence të shtuar për të mundësuar verifikimin e këtij fakti. Në vijim të këtij arsyetimi, në këndvështrim të të gjitha rrethanave të përshkruara më lart, trupi gjykues nuk vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë të kësaj pasurie.
78. Në kuadër të kontrollit të ushtruar ndaj konkluzionit përfundimtar të Komisionit për deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me mosdeklarimin e aksioneve në shoqërinë “{***}” ShA, trupi gjykues çmoi të analizojë nëse fitimi i pronësisë dhe zotërimi në vazhdim i aksioneve të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, dhe bashkëshortit të saj në shoqërinë “{***}” ShA, e vendoste subjektin e rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesave, referuar parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016. Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues, pasi verifikoi legjislacionin në fuqi lidhur me parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, konstatoi fillimisht që subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, në momentin e blerjes së këtyre aksioneve në vitin 2009, në emër të saj dhe të bashkëshortit, në kuadër të të drejtave që i takonin këtij të fundit si punonjës i shoqërisë “{***}” ShA, nuk ka shkelur asnjë dispozitë ligjore lidhur me detyrimin që i buronte subjektit në cilësinë e zyrtarit, për të shmangur rastet e konfliktit të interesave. Në këtë kuptim, krijimi i kësaj pasurie të llojit “aksione”, nuk konstatohet të ketë qenë në kundërshtim me ligjin apo rezultat i gjendjes së konfliktit të interesit.

³⁰ Me anë të shkresës nr. {***}, datë 06.02.2020.

79. Arsyetimi i Komisionit në vendim se, si pasojë e gjendjes së konfliktit të interesit, duke iu referuar nocionit të këtij të fundit sipas parashikimeve të nenit 3 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, subjekti i rivlerësimit duhet: *të deklaronte heqjen dorë nga gjykimi i çështjeve gjyqësore ku shoqëria “{***}” ShA ka qenë palë, konform dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon heqjen dorë të gjyqtarit nga gjykimi i çështjeve gjyqësore dhe, si rrjedhojë, arritja e konkluzionit se: subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me mosdeklarimin e aksioneve në shoqërinë “{***}” ShA (në deklaratat periodike vjetore dhe atë “vetting”), pavarësisht vlerës së tyre të vogël – në vlerësim të trupit gjykues, janë të gabuar dhe të pabazuar në ligj. Referuar parashikimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, të cilat përcaktojnë se objekti i kontrollit të kriterit të pasurisë janë pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, trupi gjykues vlerëson se gjendja e konfliktit të interesit, në kontekstin e procesit të rivlerësimit (për efekt të kriterit të vlerësimit të pasurisë), duhet analizuar në raport me lidhjen që krijohet me pasuritë e subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur, ku pasojat juridike të mosjustifikimit të ligjshmërisë së burimeve të pasurive, do të krijohen në ato raste kur këto pasuri janë krijuar si pasojë e gjendjes së konfliktit të interesit.*
80. Në kontekst të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se për sa kohë, referuar rezultateve të hetimit të Komisionit në rastin objekt gjykimi, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit t’i ketë blerë aksionet në kuadër të një gjendjeje paligjshmërie apo konflikti i interesit, si dhe të ketë krijuar në vijim të ardhura apo pasuri, si pasojë e situatës së konfliktit të interesit në periudhën e konstatuar nga Komisioni se ka gjykuar çështje me palë shoqërinë “{***}” ShA, mosdeklarimi i këtyre aksioneve, si dhe gjendja e konfliktit të interesit të konstatuar në vijim në drejtim të gjykimit të çështjeve me palë shoqërinë e mësipërme tregtare, nuk mund të përfshihen në objektin e veprimtarisë së nenit 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016 dhe, si pasojë, nuk mund të prodhojnë efektet e deklaramit të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e të njëjtit ligj, lidhur me kriterin e pasurisë.
81. Trupi gjykues çmoi gjithashtu se edhe në kontekst të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, kjo situatë nuk do të kishte prodhuar pasoja juridike në disfavor të saj, ndonëse trupi gjykues vëren që Komisioni nuk e ka vlerësuar çështjen në këtë këndvështrim.
82. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues e gjen të pabazuar në ligj konkluzionin e Komisionit për deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë së llojit “aksione”, në zotërim të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, dhe bashkëshortit të saj.
83. Trupi gjykues mbajti të njëjtin qëndrim për konkluzion të pabazuar në ligj nga ana e Komisionit edhe sa i takon çështjes së të ardhurave të përfituara nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në shumën 68.440 lekë, si menaxher në shoqërinë “{***}” ShPK, për periudhën 12.11.2016 - 31.12.2016, për të cilat Komisioni kishte arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, kur ka gjykuar çështjet gjyqësore të shoqërisë “{***}” ShPK dhe administratorit V. G., ku bashkëshorti i subjektit ka qenë i punësuar, duke mos proceduar me heqjen dorë nga gjykimi, sipas dispozitave

të nenit 72/5 të Kodit të Procedurës Civile, ndonëse këto të ardhura, nga verifikimi i kryer në Kolegj, rezultoi se ishin përfshirë në analizën financiare të vitit 2016.

84. Konkluzioni i arritur nga Komisioni në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë shoqërisë “{***}” ShPK, për periudhën 12.11.2016 - 31.12.2016, u gjet i pabazuar në ligj, për sa kohë nga shqyrtimi i fakteve të konstatuara nga vetë Komisioni, të ardhurat objekt vlerësimi, të cilat edhe vetë Komisioni i kishte përfshirë në analizën e tij, nuk rezultuan që të jenë krijuar në kushtet e konfliktit të interesit për ta vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, situatë kjo e cila do të ndikonte në vlerësimin e kriterit të pasurisë.
85. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë që të ardhurat objekt kontrolli (pavarësisht vlerës së tyre prej 68.440 lekësh) ishin krijuar shumë kohë më parë se të jepeshin vendimet gjyqësore nga Gjykata e Apelit Korçë³¹, në përbërje të trupit gjykues së të cilës kishte qenë edhe subjekti i rivlerësimit, dhe ku një ndër palët ndërgjyqëse kishte qenë shoqëria “{***}” ShPK apo z. V. G., si individ. Çdo vlerësim tjetër i Komisionit në lidhje me çmuarjen e gjendjes së konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimit mbi detyrimin ligjor për të hequr dorë apo jo nga gjykimi i çështjeve me palë shoqërinë “{***}” ShPK dhe/ose personat e lidhur me këtë shoqëri, e shkëputur nga vlerësimi i pasurisë së krijuar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, u çmuan nga trupi gjykues pa ndikim në vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, si dhe në tërësi, pa ndikim edhe në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, për sa kohë për këtë kriter, Komisioni kishte vlerësuar se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar se është “i aftë”, duke arritur

³¹ - Çështja gjyqësore me paditës shoqërinë “{***}” ShPK dhe të paditur “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, me objekt: “Pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, faturë tatimore shitje energjie elektrike e CEZ shpërndarje Sh.A. [...] Çështja rezulton të jetë regjistruar më datë 18.05.2017 dhe vendimi është dhënë më datë 18.10.2017. Subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë qenë në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues. Sipas këtij vendimi gjyqësor, gjykata ka vendosur: “Lënie në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 20.04.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec”, i cili rezulton të ketë qenë në favor të shoqërisë “{***}” ShPK.

- Çështja gjyqësore me paditës shoqërinë “{***}” ShPK dhe të paditur shoqërinë “{***}” ShPK, me objekt: “Pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, faturë tatimore e shitjes me nr. [...] Çështja rezulton të jetë regjistruar më datë 13.11.2017 dhe vendimi është dhënë më datë 07.03.2018. Subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë qenë në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues Sipas këtij vendimi gjyqësor, gjykata ka vendosur: “Lënie në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 09.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, e cila rezulton të ketë qenë në disfavor të shoqërisë “{***}” ShPK.

- Çështja gjyqësore, me paditës V. G., dhe të paditur “Ujësjellës Kanalizime Pogradec” ShA, me objekt: “Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë me 12 paga mujore, si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punës, [...] Çështja rezulton të jetë regjistruar më datë 06.02.2017 dhe vendimi është dhënë më datë 07.06.2017. Subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues Sipas këtij vendimi gjyqësor, gjykata ka vendosur: “Lënie në fuqi të vendimit nr. 8, datë 12.01.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec (e cila rezulton të ketë qenë pranë i pjesshëm i padisë së paraqitur nga z. V. G.), lidhur me [...] dhe ndryshimin e këtij vendimi lidhur me kërkimin për dëmshpërblim për ndërprerje të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuar, duke e rrëzuar këtë kërkim të z. V. G..

- Çështja gjyqësore, me paditës “Ujësjellës Kanalizime Pogradec ShA” dhe të paditur V. G., me objekt: “Shpërblim dëmi”, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues. Çështja rezulton të jetë regjistruar më datë 06.02.2017 dhe vendimi është dhënë më datë 07.06.2017. Sipas këtij vendimi gjyqësor, gjykata ka vendosur: “Lënie në fuqi të vendimit nr. 3, datë 06.01.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec (e cila rezulton të ketë qenë rrëzim i padisë së paraqitur nga UK Pogradec), në favor të z. V. G..

një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

86. *Lidhur me shkakun e ankimit mbi shumën e mbetur pa shlyer që përfaqëson qiranë, sigurimin shëndetësor dhe shkollimin deri në përfundim të vitit shkollor, tetor të vitit 2017, të djalit të subjektit të rivlerësimit A. T., në shumën 3.014,8 euro, për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për deklarim të pasaktë të këtyre shpenzimeve, me pretendimin se shpenzimet e shkollimit të djalit kanë qenë të sakta dhe provohen nga lëvizjet bankare, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se si pasojë e mospërputhjeve në vlera të shpenzimeve të kryera nga ana e personit të lidhur A. T. (djali i subjektit të rivlerësimit) lidhur me jetesën dhe shkollimin e tij në Gjermani, vlerësuar këto në raport me: (i) deklarimin e kryer në deklaratën periodike për vitin 2015 nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur A. T. (si person me detyrim deklarimi sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar³²); (ii) përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me pyetësorët e Komisionit³³ gjatë procedurës së hetimit administrativ; si dhe (iii) verifikimin e lëvizjeve të llogarisë bankare të personit të lidhur në “Targo Bank”, në Gjermani, Komisioni, me të drejtë, ka konstatuar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 përpara ILDKPKI-së subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë, në përputhje me detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 4, shkronja “h” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, shpenzimet e kryera lidhur me shkollimin dhe jetesën e z. A. T. në Gjermani.*
87. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit në kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit për deklarim të pasaktë, se vlera prej 2000 eurosh, e cila krijonte mospërputhjen mes shpenzimeve të kryera referuar lëvizjeve në llogarinë bankare të z. A. T. dhe atyre të deklaruara, nuk përbënte një shpenzim për atë vit kalendarik, pasi kjo shumë e tërhequr nga kjo llogari bankare ishte vënë garanci për zgjatjen e vizës, duke qëndruar e pashpenzuar, për të mbuluar shpenzimet e shkollimit në vitin vijues (2016), u gjet i pabazuar në fakte. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues çmoi se vlera prej 2000 eurosh, e pretenduar si gjendje në fund të vitit 2015, jo vetëm nuk ishte deklaruar nga ana e personit të lidhur në deklaratën periodike të vitit 2015, si shtesë e likuiditetit gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, e krijuar nga tërheqja e likuiditetit gjendje në sistemin bankar, por edhe fakti i vënies së kësaj shume si garanci për zgjatjen e vizës nuk u provua në asnjë formë, duke bërë që ky pretendim të mbetet në nivel deklarativ.
88. Pavarësisht konkluzionit të mësipërm për deklarim të pasaktë të shpenzimeve të personit të lidhur, z. A. T., në deklaratën periodike të vitit 2015 përpara ILDKPKI-së, trupi gjykues arriti në përfundimin se ky deklarim jo në përputhje me ligjin, në deklaratimet periodike vjetore nuk cenon kriterin e vlerësimit të saktësisë së deklarimit të kryer në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar lidhur me kriterin e pasurisë, për sa kohë këto shpenzime nuk përbëjnë detyrim për deklarim, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit nr. 4095 prot.,

³² Shih nenet 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.

³³ Shih përgjigjen e pyetjes nr. 15 në pyetësorin nr. 2 të Komisionit.

datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Si rrjedhojë e sa më sipër, efektet e deklarimit të pasaktë të këtij zëri shpenzimesh, shtrihen vetëm në analizën financiare të kryer për vitin 2015, ku përlogaritjet e Komisionit mbi vlerën e shpenzuar për shkollimin dhe jetesën e djalit të subjektit të rivlerësimit, z. A.T., të përlogaritura sipas vlerës së konstatuar nga lëvizjet bankare, mbeten të pandryshuara edhe pas kontrollit të ushtruar nga Kolegji.

89. *Lidhur me kundërshtimin si të pasaktë të konkluzionit të Komisionit mbi burimin e krijimit të depozitave bankare në emër të subjektit të rivlerësimit pranë Bankës Procredit dhe kundërshtimit të analizës financiare Komisionit për periudhën 2003-2016, lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme në shumën e 3.216.314 lekëve, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.*
90. Së pari, sa u takon dy depozitave bankare në emër të subjektit të rivlerësimit në Bankën ProCredit, të krijuara përkatësisht në datën 22.01.2004, në shumën 50.000 lekë, si dhe në datën 05.02.2004, në shumën 2.000 USD, trupi gjykues vëren se Komisioni ka arritur në përfundimin se lidhur me këto dy depozita, subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke arritur në këtë konkluzion sipas një analize financiare të kryer për vlerësimin e burimeve të ligjshme për krijimin e shumave të depozituara brenda periudhës kohore 01.01.2004 – 31.01.2004, dhe nisur nga premisa që subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2003, asnjë kursim gjendje *cash*.
91. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ngritur në ankimin e subjektit të rivlerësimit për konkluzion të gabuar të Komisionit lidhur me krijimin e këtyre depozitave, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit, si dhe analizoi legjislacionin e zbatueshëm lidhur me deklarimin për herë të parë të subjekteve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, vlerësoi se qasja e Komisionit për vlerësimin e burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre depozitave mbi bazën e një analize vetëm për periudhën 1 janar – 31 janar 2004, pa kryer një vlerësim mbi mundësinë për të kursyer në periudhat e mëparshme, është e gabuar pasi nuk bazohet në ligj. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin që të dyja këto depozita bankare janë çelur përpara datës në të cilën është dorëzuar formulari i modelit 5.1, që i përkiste deklarimit për herë të parë para ILDKPKI-së, në datën 16.03.2004, ku sipas parashikimit të ish-nenit 6 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, subjektet që mbartnin detyrimin për deklarim duhet të deklaronin të gjitha pasuritë e akumuluar deri në momentin e këtij deklarimi. Ndonëse trupi gjykues konstatoi se këto dy depozita nuk janë deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e plotësuar dhe të dorëzuar në ILDKPKI në datën 16.03.2004, krijimi i tyre para kësaj date është një fakt i konstatuar gjatë hetimit në Komision, sipas të dhënave nga institucioni përkatës bankar dhe, rrjedhimisht, analiza financiare lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e tyre, duhet të ishte kryer mbi bazën e

një analize të ardhurash dhe shpenzimesh deri në datën e krijimit të tyre, duke përfshirë të gjitha burimet e të ardhurave dhe shpenzimeve, edhe të viteve të mëparshme.

92. Në përfundim, trupi gjykues, nga rishikimi i kësaj analize sipas vlerësimit të mësipërm, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të njaftueshme për të justifikuar çeljen e këtyre dy depozitave bankare në Bankën ProCredit.

93. Sa i takon analizës financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003 - 2016, për të cilën Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një bilanc negativ për këtë periudhë, me mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën prej (-)3.216.314 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion të Komisionit si të pasaktë, duke referuar këtu disa gabime materiale të konstatuara në lidhje me pasqyrimin e një kredie konsumatore dhe vlerave të shpenzimeve të shkollimit të djalit E. T. në vitin 2015, si dhe shpenzimeve për jetesë të djalit A. T. në Gjermani. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, në kundërshtimin e konkluzionit të mësipërm të Komisionit, ka pretenduar se ai është rrjedhojë e mosmarrjes në konsideratë të pretendimeve të saj si më poshtë:

93.1. Vlera e aksioneve në shoqërinë “{***}” ShA, e cila, sipas subjektit të rivlerësimit, është pasqyruar me vlerën e tyre nominale prej 100.000 lekësh, dhe jo me vlerën prej 5.000 lekësh në total për blerjen e letrave me vlerë, të pretenduar si të shpenzuar realisht nga ana e subjektit të rivlerësimit.

93.2. Reduktimi i shpenzimeve të jetesës për dy fëmijët, për periudhën e shkollimit pranë shkollës “{***}”, ku sipas subjektit të rivlerësimit, në shumën e paguar institucionit arsimor, është përfshirë edhe ushqimi (mëngjes, drekë dhe pasdite), si dhe veshja e shkollës.

93.3. Reduktimi i shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit: (i) për udhëtimet brenda ditës me itinerar Pogradec - Maqedoni, të cilat, sipas subjektit të rivlerësimit, janë përlllogaritur nga Komisioni shumë të larta. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se për shkak të afërsisë së qytetit të Pogradecit me Ohrin dhe Strugën, shpeshtia e këtyre udhëtimeve lidhet me këtë fakt dhe ka shërbyer si shkak për kryerjen e furnizimeve me produkte të konsumit të përditshëm. Subjekti pretendoi se nuk kanë pasur shpenzime qëndrimi dhe se shpenzimet e karburantit të përdorur kompensoheshin me vlerat më të lira të produkteve të furnizuara; dhe (ii) shpenzimet e qëndrimit në Gjermani, Austri dhe Greqi, të cilat, sipas subjektit, janë përlllogaritur në kundërshtim me metodologjinë e Kolegjit për udhëtimet pranë të afërmeve, për të cilat shpenzimet e qëndrimit duhet të llogariten në vlerën e 5 eurove/dita.

93.4. Përfshirja në analizën financiare e të ardhurave të realizuara nga shitja e automjeteve si pasojë e pretendimit se ato nuk kanë qenë objekt i tatimit sipas ligjit të posaçëm.

93.5. Mosmarrja në konsideratë e gjendjes së likuiditeteve *cash* në fund të çdo viti, duke iu referuar këtu mundësisë për të kursyer që ka rezultuar nga analiza financiare e Komisionit, duke pretenduar njëkohësisht se mosdeklarimi i këtyre kursimeve në deklaratat periodike përkatëse ka

ardhur si pasojë e moskuptimit nga subjekti i rivlerësimit mbi mënyrën e plotësimit të deklaratave periodike vjetore përpara ILDKPKI-së.

94. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, pasi kontrollloi nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, analizën financiare të kryer nga ana e Komisionit, vëren se problematikat e evidentuara nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, në parashtrimet e saj në Kolegj, mbi disa gabime materiale të Komisionit në përlllogaritjen e shpenzimeve të kryera prej tij në vitet 2015 dhe 2016, për shlyerjen e kredisë konsumatore të marrë në Bankën Tirana, janë të drejta dhe të bazuara, duke qenë se nga verifikimi i dokumentacionit bankar, rezultoi që Komisioni në analizën e tij financiare për këto vite, të kishte përlllogaritur në total një shpenzim më të lartë, përkatësisht me 302 euro për vitin 2015 dhe 52 euro për vitin 2016.
95. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për paraqitje të pasaktë nga ana e Komisionit të shpenzimeve të shkollimit të djalit E. T. në vitin 2015, në shkollën “{***}”, në vlerën e 183.250 lekëve, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit dhe konstatoi se vlera e përlllogaritur nga Komisioni ishte e njëjtë me atë të përcaktuar në shkresën e Fondacionit “{***}”³⁴ për shpenzimet e shkollimit të E. T.s në vitin 2015, në vlerën e 183.250 lekëve, e gjeti të pabazuar në fakte këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues arriti në të njëjtin përfundim për pretendim të pabazuar në fakte edhe sa i takon përlllogaritjes nga Komisioni të vlerës së shpenzimeve të jetesës së djalit tjetër të subjektit të rivlerësimit, A. T., në Gjermani, për të njëjtin vit (2015), të pretenduar në vlerën e 1000 eurove dhe jo 1733 eurove. Lidhur me shpenzimet e shkollimit dhe jetesës së djalit të subjektit të rivlerësimit, A. T., në Gjermani për vitin 2015, trupi gjykues konstatoi se ato janë përlllogaritur nga ana e Komisionit në përputhje me aktet bankare dhe duke u specifikuar në analizë sipas shpenzimeve të evidentuara nga të dhënat e dy institucioneve bankare të përfshira, përkatësisht “OTP Bank” dhe “Targo Bank”, pa i ndarë ato në nënzëra (qira, jetesë, shkollim etj.).
96. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për mosreduktimin nga ana e Komisionit të shpenzimeve të jetesës për dy fëmijët gjatë periudhës përkatëse të shkollimit të tyre në shkollën “{***}”, trupi gjykues, pasi kontrollloi rezultatet e analizës financiare përfundimtare të Komisionit³⁵, duke i krahasuar ato me rezultatet e analizës paraprake të përgatitur në përfundim të hetimit administrativ dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, mbi vlerat e shpenzimeve të ushqimit për t’u zbritur nga shpenzimet e jetesës, në shpjegimet e dhëna prej saj ndaj rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit³⁶, konstatoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, si me të drejtë konfirmuar edhe në paragrafin 21.3.4 në vendimin e Komisionit, janë marrë në konsideratë nga Komisioni³⁷.

³⁴ Me nr. {***} prot., datë 29.05.2020.

³⁵ Të paraqitur në tabelën nr. 7, në faqen 47 të vendimit të Komisionit.

³⁶ Shih “Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me konstatimet e aktit të hetimit administrativ dhe barrën e provës” në faqet 22-25.

³⁷ Nga verifikimi i kryer nga trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, u konstatua se zëri i shpenzimeve totale për vitin 2009, është ulur nga shuma 1.695.250 lekë në shumën 1.595.469 lekë (zbritur shuma prej 50.400 lekësh shpenzime ushqimi dhe 49.381 lekë shpenzime kartoni jeshil); për vitin 2010, zëri i shpenzimeve totale nga shuma 1.713.916 lekë është ulur në shumën 1.608.052 lekë (zbritur shuma 50.400 shpenzime ushqimi dhe pjesa tjetër shpenzimi prej 55.524 lekësh për kartonin jeshil); për vitin 2011, zëri i shpenzimeve totale nga shuma 1.530.043 lekë

97. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për përlllogaritje në vlera shumë të larta të shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me këtë zë shpenzimesh, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

97.1. Sa u takon udhëtimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, dhe familjarët e saj brenda ditës me destinacion Maqedoninë (Strugë dhe Ohër), për periudhën e viteve 2005 - 2016, shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur sipas vlerave të referuara nga vetë subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorëve të Komisionit mbi kostot e këtyre udhëtimeve, duke përlllogaritur në analizën financiare për periudhën 2005 - 2016, zërin e shpenzimeve të udhëtimit në shumën totale prej 2.173.580 lekësh.

97.2. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për shpenzimet e qëndrimit në Gjermani, Austri dhe Greqi, trupi gjykues vuri re se:

(i) Lidhur me udhëtimin e kryer nga djali i subjektit të rivlerësimit në Vjenë, Austri, në datat 05.07.2015 - 09.07.2015, në përlllogaritjet e tij Komisioni është bazuar në shpenzimet e deklaruara nga vetë subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, teksa është shprehur: *djali ka shpenzuar 50 euro për shpenzime kafeje dhe shpenzime për biletë avioni 250 euro*. Referuar sa më sipër, ka rezultuar që Komisioni nuk ka përlllogaritur shpenzime shtesë për qëndrimin e djalit të subjektit gjatë këtij udhëtimi, për rrjedhojë pretendimi i subjektit u gjet i pabazuar.

(ii) Lidhur me udhëtimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, dhe familjarët e saj në vitin 2014 në Greqi, kjo e fundit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka shpjeguar se për udhëtimin në vitin 2014, ka shpenzuar vetëm shumën prej 350 eurosh, shumë kjo e cila, referuar verifikimit të kryer nga Kolegji, rezulton të jetë marrë në konsideratë nga ana e Komisionit si shpenzimi i kryer për këtë udhëtim. Gjithashtu, edhe sa i takon udhëtimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, dhe bashkëshorti i saj në muajin mars të vitit 2016, në Larisa, Greqi, për 3 ditë, nga ana e Komisioni është përlllogaritur si shpenzim për këtë udhëtim, shuma prej 120 eurosh, sipas deklarimit të vetë subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit nr. 2. Trupi gjykues vëren se ndonëse subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.10.2020, të dhënë nga znj. A. K. përpara noterit publik Th. B., ku znj. K. ka deklaruar faktin se në këto dy udhëtime të muajit gusht 2014 dhe mars të vitit 2016, ajo ka mikpritur me shpenzimet e saj, subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të në banesën e familjes së saj, në adresën: “{***}”, Komisioni me të drejtë ka vlerësuar që *subjekti i*

është ulur në shumën 1.427.223 lekë (zbritur shuma 47.500 lekë shpenzime ushqimi dhe pjesa tjetër shpenzimi prej 55.320 lekësh për kartonin jeshil); për vitin 2014, zëri i shpenzimeve totale është ulur nga shuma 2.252.036 lekë në shumën 1.978.519 lekë (zbritur shuma 60.000 lekë shpenzime ushqimi dhe pjesa tjetër shpenzimi prej 50.440 lekësh për kartonin jeshil, shpenzime udhëtimi 149.077 lekë, si dhe 14.000 lekë zbritje të shpenzimeve të udhëtimit në Pogradec); për vitin 2015, zëri i shpenzimeve totale është ulur nga shuma 4.187.309 lekë në shumën 2.829.813 lekë (zbritur shuma 30.000 lekë shpenzime ushqimi dhe pjesa tjetër shpenzimi prej 55.060 lekësh për kartonin jeshil, shpenzimet e huasë nga S. K. në shumën 1.101.200 lekë, si dhe shpenzimet e udhëtimit në shumën 171.237 lekë); për vitin 2016, zëri i shpenzimeve totale është ulur nga shuma 1.713.916 lekë në shumën 1.608.052 lekë (zbritur shuma 30.000 lekë shpenzime ushqimi dhe pjesa tjetër shpenzimi prej 54.108 lekësh për kartonin jeshil, si dhe shpenzimet e udhëtimit në shumën 33.818 lekë).

rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor, shpenzimet e udhëtimeve të kryera prej tij, për të cilat ka pretenduar shpenzime me vlerë më të ulët se ato të llogaritura nga Komisioni, për sa kohë kjo deklaratë noteriale nuk është shoqëruar me një dokumentacion të rregullt të lëshuar nga autoritetet e shtetit grek lidhur me vërtetimin e faktit se në periudhën kohore gjatë së cilës janë kryer këto udhëtime, znj. A. K. provonte të ishte rezidente në adresën e deklaruar. Megjithatë, trupi gjykues, nga një përlllogaritje e shpenzimeve të udhëtimit sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, konstaton se diferenca në vlerë e përlllogaritur më shumë nga Komisioni është gjithsej 276 euro, vlerë kjo e cila edhe nëse do të pranohej, nuk vlerësohet se sjell ndryshim thelbësor në rezultatin përfundimtar të analizës financiare.

(iii) Sa u takon udhëtimeve të kryera në vitet 2015 dhe 2016 nga subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, dhe familjarët e saj Halkidiki, Greqi, nga verifikimi i kryer në Kolegj mbi përlllogaritjet e Komisionit për këto dy udhëtime, trupi gjykues konstatoi se ato janë përlllogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar nga Kolegji³⁸ për shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit në rastet kur këto shpenzime janë përballuar nga subjektet. Kjo përlllogaritje e Komisionit u gjet e drejtë dhe e bazuar, për sa kohë vetë subjekti i rivlerësimit ishte shprehur në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit se gjatë këtij udhëtimit kishte qëndruar në dhoma me qira.

(iv) Sa u takon shpenzimeve të udhëtimit të kryera me destinacion Gjermaninë, përkatësisht 6 ditë në vitin 2014 (24.06.2014 - 30.06.2014) nga bashkëshorti dhe djali i subjektit të rivlerësimit, 6 ditë në muajin janar të vitit 2015 (14.01.2015 - 20.01.2015) nga bashkëshorti dhe djali i subjektit të rivlerësimit, si dhe 5 ditë në muajin qershor të vitit 2015 (25.06.2015 - 30.06.2015) nga subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti dhe djali i saj, trupi gjykues vëren se Komisioni ka përlllogaritur si shpenzim total për secilin prej këtyre udhëtimeve, vlerën e deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit nr. 2. Ndërkohë që subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes nr. 19 të të njëjtit pyetësor, ka deklaruar: *Nuk kam pasur udhëtime për të cilat shpenzimet të jenë mbuluar nga persona të tjerë* – duke plotësuar rrjedhimisht edhe vlerat e shpenzuara për secilin udhëtim sipas tabelës përkatëse, dorëzuar bashkëlidhur këtyre përgjigjeve, në shpjegimet e dhëna ndaj rezultateve të hetimit ka pretenduar sërish shpenzime udhëtimit sipas vlerave të deklaruara më parë në pyetësor. Në mbështetje të këtyre vlerave, ka depozituar edhe një deklaratë noteriale të datës 05.10.2020, identifikuar me nr. {***}, {***}, të lëshuar nga z. B. B., i cili deklaroi se u ka ofruar miqve të familjes së tij, A. T. dhe A. T., akomodim në banesën e tij ({***}) në qershor të vitit 2014 dhe janar të vitit 2015 për gjithsej 6 (gjashtë) ditë, si dhe në qershor të vitit 2015 për një total prej 5 ditësh, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit në këtë udhëtim. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përlllogaritje me vlera më të larta të shpenzimeve të qëndrimit për këto tri udhëtime me destinacion Gjermaninë, në vitet 2014 dhe 2015. Trupi gjykues konstaton për më tepër që nëse shpenzimet e këtyre udhëtimeve do të përlllogariteshin në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga Kolegji, duke pranuar edhe deklaratën e z. B. B. për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit për gjithsej 11 ditë në vitet 2014 dhe 2015, pavarësisht se edhe në këtë rast deklarata e z. B. B. nuk shoqërohet

³⁸ *Shih vendimin e Kolegjit nr. 11/2019 (JR).*

nga një dokument që provon rezidencën e tij në adresën e deklaruar në datat e kryerjes së këtyre udhëtimeve, përsëri shpenzimet për këto tri udhëtime do të kapnin vlerën e 2.205 eurove në total³⁹, që rezulton të jetë 865 euro më shumë nga sa ka përllogaritur Komisioni, në total 1340 euro për këto tri udhëtime. Në përfundim të analizës së mësipërme, pretendimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me mënyrën e përllogaritjes së shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit sipas të dhënave të sistemit TIMS, u gjet i pabazuar.

98. Sa u takon pretendimeve të ngritura në ankim nga subjekti i rivlerësimit lidhur me përllogaritjen e gabuar nga ana e Komisionit të vlerës së shpenzuar për blerjen në vitin 2009, të aksioneve në shoqërinë “{***}” ShA, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk solli asnjë dokumentacion provues në lidhje me këtë pretendim, duke e lënë atë në nivel deklarativ. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar qëndrimin e Komisionit për përllogaritjen e vlerës së shpenzuar për blerjen e aksioneve pranë kësaj shoqërie, sipas vlerës së tyre nominale prej 100.000 lekësh.
99. Trupi gjykues vlerësoi gjithashtu të pabazuar në fakte dhe në ligj pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit për marrjen në konsideratë si kursim vjetor gjendje *cash*, të vlerave të rezultuara si kursim i mundshëm në analizën financiare të Komisionit për vitet me bilanc pozitiv dhe përdorimin e tyre në vitet pasardhëse (si referuar në lidhje me mbulimin e shpenzimeve të mobilimit në vitet 2008 dhe 2009 nga kursimet e pretenduara *cash* në vitin 2007, me burim të ardhurat nga shitja e apartamentit të banimit). Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pasaktësi në deklarimin e likuiditetit gjendje *cash*, si pasojë e moskuptueshmërisë mbi mënyrën e plotësimit të deklaratave periodike, nuk u vlerësuan bindëse nga trupi gjykues, për sa kohë, referuar parashikimit të nenit 4, pika “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, detyrimi ligjor për deklarimin e shtesave dhe pakësimeve të likuiditeteve nga ana e subjekteve deklaruese, në secilin lloj dhe formë që ato disponohen, *gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj*, ka qenë i qartë. Për më tepër, trupi gjykues vlerësoi se analiza financiare që kryhet nga ana e Komisionit për çdo vit të periudhës së rivlerësimit, ka për qëllim verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e

³⁹ - Përllogaritja e kostove për udhëtimin e z. A. dhe A. T., në datat 24.06.2014 - 30.06.2014 do të ishte: [shpenzime udhëtimi (70 euro shpenzime karburanti për udhëtimin me automjet Pogradec – Kapshticë - Selanik, vajtje-ardhje + 180 euro kosto biletë avioni x 2 persona) = 430 euro] + [shpenzime qëndrimi (shpenzime qëndrimi mbuluar nga B. B. për 3 ditë x 5 euro/dita x 2 persona = 30 euro) + (shpenzime qëndrimi mbuluar nga vetë subjekti për 3 ditë x 50 euro/dita x 2 persona = 300 euro) = 330] = gjithsej 760 euro shpenzim për këtë udhëtim;

- Përllogaritja e kostove për udhëtimin z. A. dhe A. T., në datat 14.01.2015-20.01.2015, do të ishte: [shpenzime udhëtimi (70 euro shpenzime karburanti për udhëtimin me automjet Pogradec – Kapshticë – Selanik, vajtje-ardhje + 180 euro kosto biletë avioni x 2 persona) = 430 euro] + [shpenzime qëndrimi (shpenzime qëndrimi mbuluar nga B. B. për 3 ditë x 5 euro/dita x 2 persona = 30 euro) + (shpenzime qëndrimi mbuluar nga vetë subjekti për 3 ditë x 50 euro/dita x 2 persona = 300 euro) = 330] = gjithsej 760 euro shpenzim për këtë udhëtim;

- Përllogaritja e kostove për udhëtimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Eileva Temo, bashkëshortit dhe djalit A. T., në datat 25.06.2015 - 30.06.2015 do të ishte: [shpenzime udhëtimi (70 euro shpenzime karburanti për udhëtimin me automjet Pogradec – Kapshticë – Selanik, vajtje-ardhje + 180 euro kosto biletë avioni x 3 persona) = 610 euro] + [shpenzime qëndrimi mbuluar nga B. B. për 5 ditë x 5 euro/dita x 3 persona = 75 euro] = gjithsej 685 euro shpenzim për këtë udhëtim.

pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të deklaruara dhe atyre të përlogaritura sipas standardeve tashmë të konsoliduara nga ana e institucioneve të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, çdo vit që rezulton me një bilanc pozitiv në analizë nuk provon faktin se subjektet kanë pasur kursime në gjendje *cash*, por mundësinë e tyre për t'i justifikuar me burime të ligjshme këto kursime nëse ato do të ishin deklaruar si të tilla në kuptim të detyrimit të sipërcituar ligjor.

100. Në përfundim të analizës së kryer mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë, në vijim të konkluzioneve të arritura më sipër në këtë vendim, lidhur me çështjet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit dhe reflektimin e këtyre konkluzioneve në zërat e analizës së Komisionit të kryer për periudhën e vlerësimit 2003 - 2016, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultuan me mungesë të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera në vitet 2009, 2010, 2014, 2015 dhe 2016, përkatësisht: në shumën (-)439.103 lekë për vitin 2009; në shumën (-)252.045 lekë për vitin 2010; në shumën (-)420.749 lekë për vitin 2014; në shumën (-)1.556.120 lekë për vitin 2015; dhe në shumën (-)353.791 lekë për vitin 2016, pra në total, për gjithë periudhën e vlerësimit, në shumën (-)3.021.308 lekë.
101. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, pasi nga kontrolli i ushtruar në Kolegj, rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera gjatë periudhës së vlerësimit, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e të njëjtit ligj, duke u gjendur për pasojë në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të këtij kriteri, në kuptim të nenit 61, pika 3 e po këtij ligji.
102. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit lidhur me shqyrtimin e denoncimit të shtetasit A. M., sipas të cilit edhe në vlerësimin e trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Temo, ishte ndodhur në situatën e konfliktit të interesit në disa raste lidhur me disa udhëtime të kryera prej saj/personave të lidhur me të me automjete të shtetasve me të cilët kishte zhvilluar procese gjyqësore, duke dhënë vendime në favor të tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, trupi gjykues, në dritën e konkluzionit përfundimtar të arritur nga Komisioni lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues në vlerësimin e këtij kriteri, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, i çmoi pa relevancë në zgjidhjen e çështjes, pretendimet lidhur me këtë denoncim nga publiku dhe, rrjedhimisht, të panevojshme për t'u marrë në analizë nga trupi gjykues.
103. Në përfundim, trupi gjykues, pavarësisht se gjeti të bazuara një pjesë të shkaqeve të ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, përsëri ato u vlerësuan të pamjaftueshme për të cenuar vendimin e Komisionit. Si rrjedhojë e konkluzioneve të mësipërme, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 33, pika 5, shkronja “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupit gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 307, datë 12.10.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 17.01.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi